



Instituti për Demokraci
dhe Ndërmjetësim



*Empowered lives.
Resilient nations.*

SHOQËRIA CIVILE NË ZONAT RURALE DHE PERIFERIKE NË SHQIPËRI

NEVOJAT, SFIDAT DHE NJË PLATFORMË VEPRIMI

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Tiranë, 2012

Ky botim u mbështet nga PNUD Shqipëri në kuadër të Projektit “Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike për të Promovuar Qeverisjen e Mirë dhe Zhvillimin”.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e PNUD-it.

Grupi i punës i IDM-së

Elona Dhëmbo, Autore kryesore
Egest Gjokutaj, Studiues
Besjana Kuci, Studiuese

Sotiraq Hroni, Këshilltar
Gjergji Vurmo, Redaktor përgjegjës

Koordinatorë vendorë

Engjellush Serjani
Bardhok Ndreca
Arta Dyrmishi
Krenar Hoxha
Luljeta Qose
Fatbardha Alimeta

Monitorimi i projektit nga PNUD Shqipëri

Entela Lako, Analiste Programi
Nora Kushti, Menaxhere Komunikimi

PASQYRA E LËNDËS

Lista e Shkurtimeve.....	5
1. Hyrje.....	6
2. Studimet dhe literatura mbi Shoqërinë Civile.....	8
2.1. Zhvillimi i Sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri.....	8
2.2. Pikat e forta, pikat e dobëta dhe sfidat.....	10
2.3. Prirjet e zhvillimit rajonal të shoqërisë civile.....	12
Prirjet e zhvillimit të shoqërisë civile në rajon.....	12
Sfidat rajonale.....	14
2.4. OShC-të në zonat rurale e periferike në Shqipëri.....	15
Prirjet e përgjithshme.....	15
Shoqatat që punojnë në zonat rurale.....	16
Sfidat.....	18
3. Vlerësim i nevojave të shoqërisë civile në zonat rurale e periferike..	19
3.1. Objektivat.....	19
Pyetjet kërkimore.....	20
3.2. Përqasja metodologjike.....	20
Rishikimi i burimeve.....	20
Intervista të thelluara me informatorët kyç.....	21
Sondazhi.....	21
Kampioni.....	21
Diskutimet në fokus-grupe.....	22
Analiza e të dhënave.....	22
4. Analiza e të dhënave cilësore.....	23
4.1. Përfshirja dhe zhvillimi i shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike.....	23
4.2. Njohuritë dhe kapacitetet e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike.....	26
4.3. Përvojat e deritanishme.....	27
4.4. Nevojat dhe sfidat.....	28
4.5. Rrjetëzimi dhe bashkëpunimet.....	30

4.6. Vazhdimësia dhe ardhmja e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike.....	32
5. Analiza e të dhënave sasiore.....	35
5.1. Profili i pjesëmarrësve në studim.....	35
5.2. Vështrim mbi shoqërinë civile në zonat rurale dhe periferike...	37
5.3. Shoqëria civile dhe mjedisi rural/periferik.....	41
5.4. Kapacitetet dhe çështjet organizative të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike.....	44
5.5. Pengesat, nevojat dhe vështirësitë.....	47
5.6. E ardhmja dhe kapacitet për planifikim.....	49
5.7. Bashkëpunimet, rrjetëzimet dhe marrëdhëniet me publikun.....	52
6. Përfundime.....	57
7. Rekomandime.....	59
8. Partnerë për një shoqëri civile aktive në zonat rurale & periferike: Një platformë alternativash.....	61
8.1. Trajtimi i sfidave dhe nevojave urgjente.....	61
8.2. Inkurajimi i partneriteteve, rrjetëzimeve dhe përfshirjen e qytetarëve.....	63
8.3. Vazhdimësia dhe ardhmja e shoqërisë civile në zonat rurale periferike.....	63
9. Burimet.....	65
10. Aneksë.....	68
10.1. Intervista gjysmë e strukturuar me informatorë kyç.....	68
10.2. Sondazhi.....	71
10.3. Intervista e fokusuar në grup.....	81

LISTA E SHKURTIMEVE

BE	Bashkimi Evropian
BiH	Bosnjë Hercegovina
FF	Federata e Fermerëve
LAGS	Grupet Vendorë të Veprimit
IPARD	Instrumenti i Ndhmës së Para-Aderimit për Zhvillim Rural (<i>Instrument of Pre-Accession Aid for Rural Development</i>)
IShC	Indeksi i Shoqërisë Civile
KASH	Këshilli i Agro-biznesit Shqiptar
OJQ	Organizatat Jo-Qeveritare
OJF	Organizatat Jo-Fitimprurëse
OShC	Organizatat e Shoqërisë Civile
OShCR	Organizatat e Shoqërisë Civile të Zonave Rurale
OXFAM	Oxford Committee for Famine Relief
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
RASP	Programi i Mbështetjes së Shoqatave Bujqësore (<i>Rural Association Support Programme</i>)
ShC	Shoqëria Civile
ShCR	Shoqëria Civile e Zonave Rurale
ShPF	Shoqata e Pavarur e Fermerëve
SI	Indeksi i Qëndrueshmërisë (<i>Sustainability Index</i>)
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillimin Ndërkombëtar (<i>Swedish International Development Agency</i>)
TACSO	Asistencë Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile (<i>Technical Assistance for Civil Society Organizations</i>)
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (<i>United States Agency for International Development</i>)

1. HYRJE

Pavarësisht progresit të dy dekadave të fundit, shoqëria civile shqiptare (ShC) has ende vështirësi përse i përket rritjes së ndikimit të saj në qeverisje, për të arritur tek qytetarët, si dhe për sigurimin e një ndikimi të qëndrueshëm të veprimtarive të saj. Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë (IShC) i vitit 2010, si edhe raporte të tjera vlerësimi të sektorit të tretë mundësojnë evidencë empirike lidhur me mospërputhjet e niveleve të zhvillimit dhe rolit të shoqërisë civile në zonat urbane kundrejt rolit dhe zhvillimit të saj në zonat rurale dhe ato periferike. Mungesa e aktorëve aktivë të ShC-së në zonat rurale dhe periferike u mohon komuniteteve të këtyre zonave përfitimet e një qeverisjeje me pjesëmarrje dhe të orientuar drejt qytetarëve si edhe nga avantazhet e procesit të integritetit. Më konkretisht, shoqëria civile është një prej aktorëve kryesorë për të ardhmen e Grupeve Vendorë të Veprimit për zhvillimin rural (Ang. LAG-s, një partneritet trepalësh ndërmjet shoqërisë civile, qeverisjes vendore, dhe sektorëve privatë) si struktura bazë nëpërmjet të cilave do të kanalizohet ndihma e BE-së për zhvillimin rural në Shqipëri (komponent i IPARD-it).

Projekti “Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike për Promovimin e Qeverisjes së Mirë dhe Zhvillimin” synon të nxisë shoqërinë civile në zonat rurale dhe ato periferike, si edhe të kontribuojë për qeverisjen e mirë nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve dhe fuqizimit të ShC, duke lehtësuar bashkëpunimin dhe partneritetin e ngushtë ndërmjet sektorit civil, autoriteteve vendore dhe rajonale, dhe partnerëve të tjerë vendorë. Kjo nismë përpiqet të stimulojë aksionin e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike si edhe të promovojë qeverisjen e mirë dhe përfshirjen qytetare në zonat më të paavantazuara dhe periferike të Shqipërisë. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të fuqizojë shoqërinë civile në zonat rurale dhe periferike të katër qarqeve për të kontribuar në zhvillimin e qeverisjes së mirë, përfshirjes dhe në përafrimin me sfidat e integritetit në BE.

Zbatimi i kësaj sipërmarrjeje shtrihet në një hark kohor prej 18 muajsh (korrik 2011 – dhjetor 2012) dhe trajton shqetësimet kryesore nëpërmjet

përbushjes së dy objektivave specifike:

1. Ndërtimi i kapaciteteve të qëndrueshëm për Shoqërinë Civile të Zonave Rurale e periferike (ShCR) si një aktor kryesor dhe i pa-zëvendësueshëm për avancimin e prioriteteve të komuniteteve rurale nëpërmjet veprimesh konkrete që bazohen mbi dhe promovojnë përbushjen e principeve demokratike bazë të një qeverisjeje përfshirëse, të përgjegjshme dhe të orientuar drejt qytetarit.
2. Rritja e ndërgjegjësimit dhe advokimi me aktorët kryesorë kombëtarë dhe vendorë për forcimin e ShCR-së, zhvillimin e alternativave për rritjen e ndikimit të sektorit të tretë në zonat rurale e periferike dhe për fuqizimin e ShCR-së dhe të aktorëve vendorë me synim përfshirjen e tyre në rrjete dhe partneritete trepalësh si një instrument efikas për trajtimin e pabarazive të zhvillimit dhe zhvillimin rural.

Ky raport vlerësues përbush fazën e parë të projektit – studimin për vlerësimin e kapaciteteve të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike në Shqipëri. Duke kombinuar teknikat sasiore me ato cilësore ky raport vlerësues ofron një panoramë historike të zhvillimit të ShC-së rurale në Shqipëri e në rajon si dhe analizon e prezanton situatën aktuale të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) rurale në Shqipëri bazuar në të dhëna sasiore dhe cilësore të grumbulluara me anë të intervistave të thelluara, pyetësorëve si dhe nëpërmjet diskutimeve në grupe për të vlerësuar gjetjet paraprake.

2. STUDIMET DHE LITERATURA MBI SHOQËRINË CIVILE

2.1. Zhvillimi i sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri

Shoqëria civile shqiptare është e re dhe studimet mbi ecurinë e saj përqendrohen kryesisht në zhvillimet post-komuniste të sektorit. Një arsye për këtë është pikëpamja se përpara viteve 1990-të nuk ekzistonin OShC të mirëfillta që vepronin në Shqipëri dhe se zhvillimet thelbësorë të sektorit të tretë kanë ndodhur gjatë periudhës post-komuniste.¹ Kjo pikëpamje është deri diku e vërtetë. Megjithatë, ekzistenca e nismave individuale, sporadike dhe të mbështetura nga diaspora të shoqërisë civile përmenden nga studiuesit që gjatë periudhës së Rilindjes Shqiptare.²

Gjatë rënies së komunizmit në Evropën Lindore, krijimi i shoqërisë civile u perceptua si krijim i një aktori kryesor për procesin e tranzicionit të vendeve ish-komuniste.³ Brenda Shqipërisë, protestat dhe grevat e fillim-viteve 1990-të të kryesura nga grupe studentësh dhe sindikatat krijuan premisat për zhvillimin e ardhshëm politik dhe qytetar të vendit.⁴ Rënia e komunizmit dhe garantimi i të drejtës për krijimin e shoqatave dhe partive politike lehtësuan zhvillimin e sektorit të tretë. OShC-të e para shqiptare u formuan si organizatë jo-qeveritare (OJQ) dhe merreshin kryesisht me veprimtari që lidheshin me të drejtat e njeriut. Ato ishin organizatat e para që luajtën një rol aktiv për monitorimin e veprimtarive të qeverisë. Vështirësitë me të cilat u përballën OShC-të gjatë viteve të para pas krijimit të tyre (1991-1997) përfshijnë zhvillimin e dobët organizativ, mungesën

1 TACSO, *Albania Needs Assessment Report*, Tiranë, 29 janar 2010, 14

2 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, *Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë. Në kërkim të qytetarëve dhe ndikimit*. Tiranë: 2010., 8. Për format e veprimtarisë qytetar gjatë Rilindjes shqiptare shih ndërmjet të tjerësh edhe Thëngjilli, Petrika. *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit*. Maluka, Tiranë: 2004 dhe Clayer, Natalie, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar. Lindja e një Kombi me shumicë myslimane në Evropë*. Botimet Përpjekja, Tiranë: 2009.

3 Hann, Christine. et.al. *Civil Society: Challenging Western Models*. Londër: Routledge, 1996.

4 Biberaj, Elez. *Shqipëria në tranzicion. Rruga e vështirë drejt demokracisë*. Tiranë: Botimet Ora, 2001

e ekspertizës profesionale dhe të përvojave të mëparshme, aftësitë e ulëta për reklamimin e veprimtarive të tyre dhe një infrastrukturë komunikimi të dobët.⁵

Rënia e skemave piramidale në Shqipëri në vitin 1997 dhe lufta në Kosovë e vitit 1999 sfiduan zhvillimet e brendshme dhe rritën nevojën për asistencë nga shoqëria civile. Kjo ndikoi zhvillimin e OShC-ve për sa i përket numrit të tyre, misionit, qëllimit të veprimtarive, sasisë të fondeve, niveleve të përfshirjes vullnetare, advokimit, imazhit publik dhe metodave të qeverisjes. Një zhvillim i rëndësishëm i kësaj periudhe është edhe dalja në pah e instituteve kërkimore (*think-tank*) si një formë e re OShC-sh e pazhvilluar më parë.⁶ Pavarësisht zhvillimeve pozitive në sektorin e tretë, Indeksi i Qëndrueshmërisë së Shoqërisë Civile i USAID-it nxjerr në pah se përgjatë kësaj periudhe (1997-2005) shumica e treguesve si mjedisi ligjor, kapacitetet organizative dhe shpërndarja e shërbimeve u vlerësuan njësoj ose më ulët krahasuar me vitet e mëparshme.⁷

Dy tipare kryesore që karakterizojnë zhvillimin e sektorit të tretë në Shqipëri pas vitit 2005 janë prirja në rritje e aktorëve të ShC-së për të kaluar në politikë dhe tkurrja e fondeve nga donatorët e huaj për OShC. Rënia e mbështetjes financiare ka sjellë gjithashtu dhe rënien e përmasave, qëllimeve dhe veprimtarive të sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri. Si rrjedhojë, të gjithë OShC-të janë përballur me vështirësi që burojnë nga tkurrja e fondeve dhe interesit nga donatorët e huaj, rritja e konkurrueshmërisë së mjedisit politik dhe bashkëngjitja e shumë prej udhëheqësve të tyre në formacionet politike, rënia e anëtarësisë në shoqata dhe rrjete dhe rënia e ofrimit të shërbimeve nga shoqatat ekzistuese.⁸

Pavarësisht këtij fenomeni, përpjekje të vazhdueshme janë ndërmarrë nga aktorët shtetërorë lidhur me përmirësimin e legjislacionit që rregullon veprimtarinë e shoqërisë civile. Ligji për OJF-të u miratua në vitin 2001 dhe në tetor 2007 u caktua një zë i veçantë në Buxhetin e Shtetit për mbështetjen e shoqërisë civile. Në mars të vitit 2009 u miratua Ligji për “Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Mbështetëse të Shoqërisë Civile”. Hapa të tjerë të ndërmarrë kryesisht nga organizatat ndërkombëtare që mbështetin zhvillimin e shoqërisë civile përfshijnë edhe konkretizimin dhe miratimin e

5 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, *Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë. Në kërkim të qytetarëve dhe ndikimit*. Tiranë: 2010, Fq. 9-11

6 Edhe pse *think tanku* i parë u themelua në vitin 1991, 70% e këtyre organizatave në Shqipëri janë themeluar gjatë periudhës 1997-2001. Shih Euclid dhe Human Development Promotion Center, *Third Sector Development in Albania. Challenges and opportunities*. Tiranë: 2009, 22

7 Po aty, 26-28

8 Po aty, 30

Kartës së Shoqërisë Civile në vitin 2009. Pavarësisht përpjekjeve pozitive, marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të qeverisë dhe OShC-ve mbeten relativisht të pazhvilluara. Për më tepër, mbetet mbizotërues perceptimi mbi OShC-të si një oponent politik i qeverisë. Po ashtu, është krijuar perceptimi se shumë OShC ekzistojnë për t'i shërbyer interesave private individuale ose të grupeve të caktuar e jo interesave të publikut të gjerë.⁹

2.2. Pikat e forta, pikat e dobëta dhe sfidat

Pikat e forta

- OShC-të kanë përmirësuar kapacitetet e tyre lobuese dhe advokuese për ndikimin në politikëbërje.
- OShC-të shqiptare janë të hapura ndaj mundësive për rrjetëzim dhe shkëmbim informacioni.
- Presioni tek aktorët shtetërorë për bashkëpunim me OShC-të mbetet i qëndrueshëm.
- OShC-të janë më të mirë-pajisura me kapacitete komunikimi dhe më të ndërgjegjësuar rreth rolit të tyre sesa institucionet shtetërore sidomos për sa i përket ndërveprimit me donatorët dhe grupet përfituese.
- Shoqëria civile ka shënuar rezultate pozitive në promovimin e vlerave sociale (si harmonia fetare, marrëdhëniet ndëretnike, etj.) jo vetëm në vend por edhe përtej kufijve.
- Veprimtaritë konkrete dhe me synime të qarta të OShC-ve si trajnimet për njerëzit në nevojë dhe grupet e marginalizuara kanë pasur sukses për tërheqjen e vëmendjes dhe sigurimin e mbështetjes së qytetarëve.

Pikat e dobëta

- OShC-të shqiptare shfaqin qëndrueshmëri të dobët financiare dhe sektori varet gjerësisht nga financimet e donatorëve të huaj. Me tkurrjen e financimeve të huaja, qëndrueshmëria e shoqërisë civile si edhe veprimtaritë e OShC-ve shqiptare janë të rrezikuara.
- OShC-të vuajnë nga mungesa e pjesëmarrjes qytetare dhe nga indiferentizmi i lartë i qytetarëve kundrejt veprimtarive të tyre. Shumë qytetarë perceptojnë anëtarësinë në OShC si mënyrë për të siguruar përfitime personale dhe jo si një sipërmarrje në shërbim të ndryshimeve shoqërore. Niveli i lartë i indiferentizmit dhe skepticizmit kundrejt veprimtarive të shoqërisë civile vërehet jo vetëm ndërmjet publikut të përgjithshëm por edhe brenda grupeve shoqërore, të cilët janë më të informuar rreth misionit të shoqërisë civile.

9 TACSO, *Albania Needs Assessment Report*, Tiranë, 29 janar 2010, f. 11.

- Shoqëria civile ka luajtur një rol të rëndësishëm për promovimin e demokracisë dhe qeverisjes së mirë në përgjithësi, por ka probleme me zbatimin e këtyre parimeve brenda OShC-ve. Kjo ndikon negativisht në veprimtarinë dhe besueshmërinë e këtij sektori.
- Shoqëria civile në Shqipëri identifikohet gjerësisht me OShC-të që veprojnë në qytetet e mëdha dhe organizatat që veprojnë në zonat rurale dhe periferike mbeten të panjohura.
- Pavarësisht hapave pozitivë, bashkëpunimi ndërmjet qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit privat është i ulët. Ndasitë politike ndërmjet disa përfaqësuesve të OShC-ve ndikojnë negativisht objektivitetin dhe mbështetjen nga publiku.

Sfidat

- OShC-të duhet të intensifikojnë përpjekjet për angazhimin e qytetarëve dhe të përfituesve kryesorë. Ato duhet të rrisin përfshirjen në planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të veprimtarive të tyre si dhe të mundësojnë që qytetarët / përfituesit të jenë më aktivë. Kjo do të përmirësonte aktivizmin qytetar, do të forconte nismat për vullnetarizëm dhe do të kontribuonte për uljen e apatisë qytetare kundrejt OShC-ve.
- OShC-të duhet të diversifikojnë fokusin e tyre, fushat e veprimtarive si edhe të gjenerojnë ide dhe strategji për diversifikimin e burimeve financiare dhe për qëndrueshmërinë financiare.
- Transparenca dhe qëndrueshmëria mbeten sfida për vetë OShC-të, për financuesit e tyre dhe për aktorët kryesorë si qytetarët, grupet e interesit dhe institucionet shtetërore.
- Nevojitet lobimi për hartimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe grupeve të interesit dhe për të rritur ndikimin e sektorit të tretë.
- Nevojitet rritja e bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet donatorëve dhe OShC-ve për të tejkaluar fragmentizimin aktual gjeografik dhe tematik të sektorit të tretë

Për një vështrim më të detajuar lidhur me pikat e forta, dobësitë dhe sfidat shih gjithashtu Institute for Democracy and Mediation, *An Action Agenda for Civil Society. The Path to Increased Impact and Civic Engagement*. Policy Brief, Tiranë: korrik 2010; Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, *Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë. Në kërkim të qytetarëve dhe ndikimit*. Tiranë: 2010, dhe Euclid dhe Human Development Promotion Center, *Third Sector Development in Albania. Challenges and opportunities*. Human Development Promotion Center, Tiranë: 2009

2.3. Prirjet e zhvillimit rajonal të shoqërisë civile

Prirjet e zhvillimit të shoqërisë civile në rajon

Pavarësisht dallimeve në ecurinë dhe stadin e përparimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të procesit të Stabilizim Asocimit, ekzistojnë disa probleme të përbashkëta që kërkojnë më shumë vëmendje. Forcimi i demokracisë në vend në përgjithësi dhe zhvillimi i mëtejshëm e i qëndrueshëm në veçanti janë disa prej përparësive më urgjente. Për më tepër, si në BE ashtu edhe në Ballkanin Perëndimor zhvillimin rural nuk duket se përbën një problem të vogël ose periferik.¹⁰

Krahas përfitimeve të dukshme në fillim të viteve 1990-të, progresi në zonat rurale të Ballkanit Perëndimor duket se ka ngecur. Një përqindje e lartë e popullsisë ekonomiksht aktive e rajonit është e punësuar në bujqësi (rreth 20%) dhe një pjesë e mirë popullsisë jeton në zonat rurale (rreth 46%).¹¹ Për më tepër, bujqësia kontribuon më pak në PBB-të e vendeve të Evropës Jugore (më pak se 4% e PBB-së) krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor (ndërmjet marzhit 9-20% e PBB-s).¹² Zhvillimi i zonave rurale e periferike në vendet e Ballkanit Perëndimor aktualisht përballet me një sërë sfidash politike, ekonomike dhe sociale.

Në Bosnjë Hercegovinë (BiH), 6.4% e OShC-ve të regjistruara veprojnë në nivel qendror. Në vitin 2008 kishte mbi 12,000 organizata të regjistruara; 55% e të cilave ishin ende aktive. 51.1% e OShC-ve të regjistruara veprojnë nga qytetet e vogla në zonat rurale. 23% e OShC-ve bazohen në qytetet e mëdha dhe 7.7% e tyre janë të vendosura në zonat rurale.¹³ Një nismë e suksesshme e shoqatave që veprojnë në zonat rurale në BiH është krijimi i Shoqatës së Pavarur të Fermerëve (ShPF), krijuar për të forcuar njësitë vendore dhe private bujqësore në rajonin Upper Verba. ShPF ka mundur kredi të vogla me anë të një partneriteti tregtar me një bankë lokale, ka organizuar fermerët për blerjen e përbashkët të inputeve dhe shitjen e produkteve si edhe ka lobuar tek politikëbërësit vendorë për

10 International Center for Democratic transition, *Enhancing Sustainable Rural Development in the SAP Countries by Introducing the LEADER Experience*. f. 2

11 Sipas statistikave në Shqipëri 55 deri në 57 përqind e popullsisë jetojnë në zonat rurale. Shih Rural Poverty Portal, <http://www.ruralpovertyportal.org/web/guest/country/home/tags/albania>

12 Lampietti, Julian, Lugg, David, Van der Cellen, Philip, Branczik, Amelia *The Changing Face of Rural Space. Agricultural and Rural Development in Western Balkans*. The World Bank, Washington D.C.: 2009.

13 Sterland, Bill. dhe Rizova, Gallna. *Civil Society Organizations' Capacities in the Western Balkans and Turkey. A comparative Study of the Eight Country's Needs Assessment.*, 2010, faqe 8.

çështjet e bujqësisë.¹⁴

Në Kroaci ekzistojnë rreth 39,000 OShC të regjistruara që përbëjnë 93% të shoqatave që njihen në vend.¹⁵ Sipas statistikave të vitit 2007, 50.4% e OShC-ve kroate të regjistruara bazoheshin në kryeqytet dhe në rajonet kryesorë.¹⁶ Gjatë tranzicionit post-jugosllav, fermerët u organizuan në shoqata dhe në vitin 1998 krijuan Shoqatën e Fermerëve të Kroacisë. Megjithatë duket se fermerët kroatë nuk kanë ndikim të konsiderueshëm tek vendimmarrësit kryesorë për zonat rurale.¹⁷

Në Kosovë, më pak se 20% e OShC-ve të regjistruara janë aktive dhe shoqëria civile mbetet e dobët dhe e nën-zhvilluar. Shumica e OShC-ve janë të përqendruara në kryeqytet dhe në qytetet e tjerë të mëdhenj si Pejë, Prizren dhe Mitrovicë.¹⁸ OShCR-të në Kosovë janë të vogla dhe kanë ndikim të kufizuar. Disa nisma të tyre përfshijnë një projekt të financuar nga USAID me titull “Ndërtimi i Aleancës ndërmjet Prodhuesve Kosovarë të Qumështit dhe Fermerëve Serbë”,¹⁹ projektin e ndërmarrë nga Korpusi i Paqes me Shoqatën e Fermerëve në Mogila²⁰ dhe shoqatat mjedisore edhe pse këto të fundit nuk bazohen gjithnjë në zonat rurale.²¹

Në Maqedoni ekzistojnë 9,000 OShC të regjistruara dhe rreth 2000 prej tyre janë aktive. OShC-të maqedonase përqendrohen kryesisht në zonat urbane, ku 43% e tyre bazohen në kryeqytet dhe në qendrat urbane më të mëdha. Sipas statistikave të vitit 2007, përfaqësimi i OShC-ve në zonat rurale është i ulët (6.3%)²² dhe në vitin 2010 shpërndarja e tyre ishte 0.5 OShC për 1000 banorë.²³ Praktika të suksesshme të OShCR-ve

14 Faqja e internetit e Partners for Development: Bosnjë Hercegovinë. <http://www.pfd.org/where-we-work/bosnia-a-herzegovina>

15 Sterland, Bill. dhe Rizova, Gallna. *Civil Society Organizations' Capacities in the Western Balkans and Turkey. A comparative Study of the Eight Country's Needs Assessment.*, 2010, faqe 9

16 Civicus, *Global Survey for Country Reports*. Vol. 1 Country Profile., Kumarian Press INC, USA: 2007, 68.

17 Brkic, Srecko. Zutinic, Durdica. & Tratnik, Miroslav. *Articulation of the Farmer's Interest through Protests*. Sociology and Space, vol. 42, No .314, , 247

18 Sterland, Bill. dhe Rizova, Gallna. *Civil Society Organizations' Capacities in the Western Balkans and Turkey. A comparative Study of the Eight Country's Needs Assessment.*, 2010, faqe 11

19 USAID, “Kosovo Cluster and Business Support Project. Building Alliances between Kosovo Association of Milk Producers and Serbian farmers.”, 2005.

20 Mercy Corps work in Kosovo “Not Small Potatoes”, 9 gush 2010

21 Shembuj të organizatave mjedisore përfshijnë: Aquila (Pejë) dhe Eko-Klina (Klinë). Shih USAID, Kosovo biodiversity Assessment. 2003:, 16

22 Civicus, *Global Survey for Country Reports*. Vol. 1 Country Profile., Kumarian Press INC, USA: 2007, 233

23 Sterland, Bill. dhe Rizova, Gallna. *Civil Society Organizations' Capacities in the Western Balkans and Turkey. A comparative Study of the Eight Country's Needs Assessment.*, 2010, faqe 13

në vend përfshijnë themelimin e Federatës së Fermerëve të Republikës së Maqedonisë me mbështetjen e SIDA-s. Kjo nismë perceptohet si sukses sepse u ofron fermerëve një organizatë gjithëpërfshirëse që mundëson pjesëmarrjen e tyre në negociata gjatë procesit të vendimmarrjes.²⁴

Në Malin e Zi, ekzistojnë 5,459 OShC të regjistruara dhe 55% e tyre janë të përqendruara në zonat më të populluara duke përfshirë Podgoricën (43.5%), rajonin bregdetar jugor (22%) dhe rajonin verior (22.5%)²⁵. Ndër projektet e suksesshëm të ndërmarra në zonat rurale të Malit të Zi është edhe një nismë financuar nga USAID-i me anë të Programit “Rigjallërimi i Komunitetit me anë të Veprimit Demokratik” Action dhe zbatuar nga International Relief and Development Association në rajonet e Barit dhe Ulqinit. Ndiham dhe përvoja e mundësuar gjatë këtij programi trefishoi prodhimin e vajit të ullirit dhe sukcesi i këtij projekti ka nxitur dhe prodhues të ullirit në zona të tjera të vendit për të rigjeneruar parcelat e tyre.²⁶

Në Serbi ekzistojnë pak të dhëna mbi OShC-të dhe nuk ka një regjistër kombëtar të këtyre organizatave. Statistikat e përafërta theksojnë se ka rreth 25,000 OShC të regjistruara nga të cilat rreth 3000 prej tyre janë aktive. Veprimtaria e OShC-ve përqendrohet në kryeqytet dhe në qendrat e mëdha rajonale, si, për shembull, në Novi Sad në veri.²⁷ Në lidhje me OShC-të e zonave rurale në Serbi nuk rezulton ndonjë zhvillim domethënës. Kjo shpjegohet deri diku me mungesën e mbështetjes nga donatorët ndërkombëtarë dhe institucionet kombëtare për organizatat që veprojnë jashtë zonave qendrore.²⁸

Sfidat rajonale

- Të dhënat, informacioni i detajuar dhe literatura për OShC-të që punojnë në zonat rurale në Ballkanin Perëndimor është i pakët.
- Veprimtaritë e organizatave që punojnë në zonat rurale përqendrohen kryesisht në një zonë të ngushtë dhe praktikata e tyre më të suksesshme

24 Swedish International Development Agency, (2009), “Macedonian farmers find a voice.”

25 Sterland, Bill. dhe Rizova, Gallna. *Civil Society Organizations’ Capacities in the Western Balkans and Turkey. A comparative Study of the Eight Country’s Needs Assessment.*, 2010, faqe 11

26 USAID, Europe and Euroasia, “Cultivating a Symbol for Peace: Re-vitalizing Montenegro’s Olive Industry.” http://www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/press/success/2006-02-20.html.

27 Sterland, Bill. dhe Rizova, Gallna. *Civil Society Organizations’ Capacities in the Western Balkans and Turkey. A comparative Study of the Eight Country’s Needs Assessment.*, 2010, faqe 12-13

28 Cicea, Claudio. Subic, Jonel dhe Ivanovic, Sanjin, “Economic effectiveness of activities of vegetable growers’ associations in Serbia.” *Economia Seria Management*, Vol.1. Nr.1. 2009., 13

nuk ndahen gjerësisht me komunitete të tjera me problematikë dhe situata të ngjashme.

- Nga një këndvështrim rajonal, pavarësisht variacioneve ndërmjet komuniteteve, ekziston një disproporcion dukshëm në disfavor për OShC që veprojnë në zonat rurale krahasuar me ato që veprojnë në zonat urbane.
- OShC-të e zonave rurale në rajon shfaqin nivele të ulëta kapacitetesh organizative.
- OShC-të rurale dhe lokale në Ballkan janë më së shumti me bazë vendore, të orientuara drejt komunitetit të tyre specifik dhe veprojnë kryesisht në nivel Bashkish, komunash dhe komunitetesh.
- OShC-të e zonave rurale dhe të qyteteve të vogla nuk janë të ndërgjegjshme për potencialin e tyre për të dhënë inpute për institucionet relevante të qeverisë dhe administratës publike si edhe për ndikimin e politikave sociale.²⁹

2.4. OShC-të në zonat rurale e periferike në Shqipëri

Prirjet e përgjithshme

Pjesa më e madhe e problematikave që lidhen me OShC-të në Shqipëri vlejnë edhe për OShCR-të. Gjithsesi, literatura mbi identifikimin, pozicionimin, kapacitetet dhe veprimtaritë e këtyre shoqatave është edhe më e pakët sesa ajo për zhvillimet e përgjithshme të sektorit. Nga kërkimet e kryera deri tani duket se nuk ka burime që i drejtohen veçanërisht OShC-ve të zonave rurale / periferike dhe problematikës së tyre në Shqipëri.

Në përgjithësi, shumica e OShC-ve shqiptare janë të bazuara në Tiranë dhe një pjesë më vogël e tyre bazohen në qytetet e Shqipërisë Qendrore (Durrës, Elbasan), në veri (Shkodër) dhe në jug (Vlorë, Gjirokastrë). Shoqëria civile duket se përfaqësohet dobët në zonat rurale e periferike. Sipas të dhënave të një pyetësoi të vitit 2009, 89% e OShC-ve bazohen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Tiranë dhe në qytetet kryesore dhe vetëm 11% e tyre bazohen dhe punojnë në qyteza dhe fshatra.³⁰ Edhe pse OShC-të shqiptare që veprojnë në zonat rurale dhe periferike janë të vogla, kanë pak staf me kohë të plotë, kanë aftësi profesionale dhe përvojë të kufizuar dhe nuk kanë qëndrueshmëri financiare, ato luajnë një rol të rëndësishëm

29 Shih edhe Sterland, Bill. dhe Rizova, Gallna. *Civil Society Organizations' Capacities in the Western Balkans and Turkey. A comparative Study of the Eight Country's Needs Assessment.*, 2010, faqe 12-13

30 Euclid dhe Human Development Promotion Center (2009), 31

për zhvillimin rural, i cili në pjesën më të madhe të tij mbetet ende për t'u zbuluar.³¹ Një tjetër problematikë e dukshme më së shumti kur diskutohet mbi OShC-të në zonat rurale është fakti se atyre u mungojnë kapacitetet për shkrimin e projekt-ideve, ndërtimin e koalicioneve dhe advokacinë.³²

Shoqatat që punojnë në zonat rurale

Pavarësisht mungesës së statistikave, duket që numri i OShC-ve që punojnë në nivel komune ose fshati në Shqipëri është i vogël. Edhe në rastet kur ato ekzistojnë, atyre iu mungojnë kapacitetet dhe qëndrueshmëria financiare. Megjithatë, më poshtë paraqiten disa shembuj pozitivë të organizatave që punojnë në zonat rurale në Shqipëri.³³ Një shembull i tillë janë shoqatat rurale të mikro-kredive, shoqatat e përdorimit të ujit ose Shoqatat për përdorimin e pyjeve komunalë, të cilat kanë shtrirje të gjerë të veprimtarisë së tyre në zonat rurale. Ato kanë përmirësuar kapacitetet e tyre organizative duke krijuar federata. Pavarësisht kësaj ato mbeten të dobëta dhe shpesh nuk funksionojnë siç duhet duke qenë se varen nga dëshira dhe kontributi i komunitetit në komunën apo fshatin ku ato veprojnë.³⁴

Një tjetër grup OShCR-sh që veprojnë në Shqipëri janë shoqatat e fermerëve, të cilat pas themelimit të tyre si OJF së fundmi janë zhvilluar në formën e shoqërive të bashkëpunimit reciprok, duke marrë formën e bizneseve të vogla të bazuar tek bujqësia. Disa prej tyre janë themeluar dhe mbështetur fillimisht nga donatorë ndërkombëtarë si OXFAM-i dhe Banka Botërore përgjatë disa viteve.³⁵ Veprimtaria e tyre pritet të rritet në të ardhmen edhe në sajë të një projekt-ligji që pret miratimin nga Kuvendi për shoqëritë kooperativiste bujqësore.³⁶

Një kategori e tretë OShCR-sh janë ato, veprimtaritë e të cilave lidhen me tregun bujqësor ose me aspektet e bashkëpunimit bujqësor. Këto organizata funksionojnë në formën e Federatave të Fermerëve (FF). Shembuj të tyre përfshijnë: FF e Shkodrës, FF e Myzeqesë dhe FF e Kukësit.³⁷ FF-të kanë

31 TACSO, Albania Needs Assessment Report, 29 janar 2010, 14

32 USAID Indeksi i Qëndrueshmërisë së OJF-ve në Shqipëri 2009

33 Sterland, Bill. dhe Rizova, Gallna. *Civil Society Organizations' Capacities in the Western Balkans and Turkey. A comparative Study of the Eight Country's Needs Assessment.*, 2010, faqe 8

34 Shih për më shumë informacion "Oxfam work in Albania", i disponueshëm në: http://policy-practice.oxfam.org.uk/publications/search?i=1;q=*;q1=publications;q2=agriculture;x1=p_age_type;x2=subject_area

35 Shih World Bank Tirana Office, "The World Bank Financing to Albania.", 2010: 16-18 për nisma konkrete që mbështetin këtë kategori OShC-sh.

36 Faqja e internetit e KASH, "Projekt-ligji për Shoqëritë kooperativiste bujqësore." www.kash.org.al/documents/legjislacion/Ligj%20i%20ri%20per%20Kooperativat%20Bujqesore.pdf

37 Informacion më i detajuar mbi Shoqatën e Fermerëve të Kukësit ka në: <http://fedfarmqk.org/>

vepruar si OJF që ndihmojnë fermerët ose si ndërmjetësues mes fermerëve dhe qeverisjes qendrore ose asaj vendore. Megjithatë, duhet theksuar se këtyre organizatave u mungojnë kapacitetet organizative dhe menaxhimi i mirë dhe sidomos advokimi dhe bashkërendimi i qëndrueshmërisë së tyre. Si pasojë, financim i qëndrueshëm dhe zhvillimi i mëtejshëm i burimeve njerëzore mbeten sfida thelbësore për to.

Së katërti, janë organizatat vendore të cilat veprojnë në qytete të ndryshme të Shqipërisë si për shembull Permaculture Resource Center, Shoqata për Zhvillimin Bujqësor të Dibrës, Agritra Vizion dhe Auleda (Vlorë) të cilat përbëhen nga ish-specialistë të bujqësisë dhe veprojnë në bazë të projekteve. Disa prej tyre janë mbështetur nga donatorë të huaj përgjatë viteve. Ato mund të konsiderohen deri diku një urë e mirë lidhëse ndërmjet nevojave të fermerëve të vegjël për të dalë nga apatia dhe varfëria ose për rritjen e vlerës së shtuar të veprimtarive të tyre lidhur me prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale si dhe për veprimtaritë e vogla të turizmit rural. Megjithatë, ato përballen me vështirësi të konsiderueshme lidhur me qëndrueshmërinë financiare dhe nevojën për mbrojtjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të tyre njerëzore.

Një kategori tjetër organizatash që shtrijnë veprimtaritë e tyre në zonat rurale janë OSHC-të që bazohen në Tiranë.³⁸ Veprimtaritë e tyre zhvillohen në baza *ad hoc* sipas nevojave të projekteve specifike dhe të donatorëve të veçantë dhe përqendrohen kryesisht në hartimin e dokumenteve të politikave, studimeve ose të veprimtarive të ndryshme për forcimin ose ndërtimin e kapaciteteve në nivel komune. Organizata të tilla tregojnë më së shumti karakteristikat e *think-tankeve* dhe shpesh nuk merren vetëm me zhvillimin rural, por e trajtojnë këtë fushë në kuadrin më të gjerë të veprimtarive që ato zhvillojnë. Shpesh këto organizata e bëjnë zhvillimin rural pjesë të veprimtarive të tyre, sepse agjenda e donatorëve orientohet drejt kësaj çështjeje.

Një grup tjetër institucionesh me veprimtari në zonat rurale përfshin agjencitë e zhvillimit të vendeve të BE-së të shteteve si Spanja, Italia, Gjermania, Austria si edhe organizatat fetare si për shembull CARITAS (austriak, gjerman, italian), të cilat kanë ndërmarrë kryesisht projekte për ndihmesën e zhvillimit rural kryesisht me anë të ofrimit të inputeve bujqësore (fara, bagëti etj.) ose me anë të rritjes së veprimtarive jo bujqësore si turizmi familjar në fshat. Një problematikë e përbashkët për veprimtaritë dhe projektet që financohen nga këto organizata lidhet me

38 Shembuj organizatash të tilla përfshijnë: Rural Association Support Programme (RASP) <http://rasp.org.al/Index%20al.html>; Shoqata e Bujqësisë Organike http://organic.org.al/SHQIP/index_al.html etj.

qëndrueshmërinë financiare pas tërheqjes së donatorit si dhe me çështje të rritjes së kapaciteteve të brendshme që përbëjnë elementet kryesorë për sukses dhe përfaqësi të gjerë.

Grupi i fundit por jo më pak i rëndësishëm përbëhet nga donatorët ndërkombëtarë si PNUD-i, Banka Botërore, OXFAM, BE dhe shumë të tjerë, të cilët kanë mbështetur zhvillimin e OShC-ve në zonat rurale dhe në qytezat e Shqipërisë. Një nismë e ndërmarrë në këtë kuadër është edhe Projekti “Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar në Rajonin e Kukësit” mbështetur financiarisht nga PNUD-i në Shqipëri dhe BE-ja dhe zbatuar në bashkëpunim të ngushtë me aktorët kryesorë vendorë, qendrorë dhe ndërkombëtarë që përfshijnë strukturat e qeverisjes vendore dhe OShC-të vendase të rajonit të Kukësit. Projekti ka synuar që të forcojë kapacitetet e aktorëve rajonalë për t’i përgatitur ata për të marrë pjesë si palë përfituese në projektet ndërkufitare dy palësh ekzistues dhe ata të ardhshëm.³⁹

Sfidat

- Ka mungesë literature specifike që lidhet me OShC-të që veprojnë në zonat rurale në Shqipëri.⁴⁰
- Sfidat dhe shqetësimet e komuniteteve rurale përfshirë edhe çështjen e aktivizimit të sektorit të tretë në këto fusha mbeten periferike në agjendën dhe programin e organizatave të njohura të shoqërisë civile.
- OShC-të e komuniteteve rurale edhe kur ekzistojnë u mungon përvoja e duhur, kapacitetet ose rrjeti i aktorëve qytetarë që do të kontribuonte për qeverisjen vendore, zhvillimin e komunitetit si edhe për përshpejtimin e procesit të aderimit në BE.
- Është emergjente trajtimi i nevojës për trajnim dhe forcimin e kapaciteteve të OShC-ve që bazohen në qyteza dhe zona rurale.⁴¹

Duke marrë parasysh sfidat dhe problematikën e sipërpërmendur, ndërhyrja e këtij projekti synon të rigjallërojë shoqërinë civile në zonat rurale/periferike dhe të promovojë qeverisjen e mirë dhe përfshirjen qytetare në zonat më periferike të Shqipërisë. Ndërhyrja do të fillojë me ndërmarrjen e një studimi vlerësues në katër qarqe për vlerësimin e kapaciteteve dhe nevojave të shoqatave që punojnë në zonat rurale dhe ato periferike.

39 Faqja e internetit e PNUD-it në Shqipëri, “Kukës Region Cross Border Cooperation Programme (KRCBC) shtator 2009 – maj 2011” <http://www.undp.org.al/index.php?page=projects/project&id=186>

40 Sterland, Bill, dhe Rizova, Gallna, *Civil Society Organizations’ Capacities in the Western Balkans and Turkey. A Comparative Study of the Eight Countries Needs Assessment.*, 2010

41 Europartners Development dhe AYNEY, “Increasing the Capacities of Albanian NGOs towards Future Sustainability.” 2009

3. VLERËSIM I NEVOJAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË ZONAT RURALE E PERIFERIKE

3.1. Objektivat

Identifikimi i nevojave të OShC-ve në zonat rurale dhe periferike të Shqipërisë synon të ofrojë informacion të detajuar për natyrën, mundësitë, sfidat/nevojat dhe boshllëqet në fushat tematike të veprimtarive të tyre në këto zona. Zonat gjeografike specifike ku shtrihet ky studim janë përzgjedhur të jenë qarqet Gjirokastrë, Berat, Lezhë dhe Elbasan duke u përpjekur që të mbulohet diversiteti i zhvillimit të Shqipërisë.

Objektivat e identifikimit dhe vlerësimit të nevojave të OShC-ve në zonat rurale e periferike përfshijnë:

- Identifikimi i OShC-ve kryesore që veprojnë në zonat rurale të qarqeve Berat, Gjirokastrë, Lezhë dhe Elbasan dhe i profileve të tyre.
- Matja e nivelit të njohurive të OShC-ve mbi rolin e shoqërisë civile
- Krahësimi ndërmjet OShC-ve të zonave rurale dhe atyre të zonave urbane do të ndihmojë për të nxjerrë në pah ndryshimet dhe ngjashmëritë ekzistuese ndërmjet tyre
- Identifikimi i fushave tematike të zhvilluara dhe të suksesshme.
- Identifikimi i sfidave kryesore dhe nevojave ekzistuese.
- Hartëzimi i zonave gjeografike që mbulohen me nisma konkrete dhe i boshllëqeve që lidhen me fushat tematike të pa mbuluara.
- Shtjellimi i mundësive që OShC-të rurale të ndërtojnë dhe zgjerojnë më tej partneritetet dhe kapacitetet e tyre, sidomos në kuadër të anëtarësimit në BE (programet e asistencës së BE-së për zhvillimin rural).
- Vlerësimi i sfidave për një rol kuptimplotë të OShCR-ve në përmirësimin e qeverisjes vendore, fuqizimin e komunitetit dhe të grupeve të marginalizuara dhe vulnerabël duke përfshirë çështjet e grave, të rinjve dhe të komunitetit rom.

Pyetjet kërkimore

Studimi udhëhiqet nga pyetjet kërkimore të parashtruara më poshtë:

- Cila është situata aktuale e OShC-ve në zonat rurale dhe ato periferike të qarqeve të synuara?
- Cili është niveli i aktivizmit dhe njohurive për rolin që OShC-të duhet të luajnë në komunitet dhe në sistemin e qeverisjes vendore?
- Ç'lloj nismash/veprimtarish ekzistojnë në këto zona?
- Cilat janë sfidat me të cilat përballen OShCR-të gjatë zbatimit të këtyre veprimtarive/nismave? Cilat janë nevojat e tyre specifike?
- Në cilat fusha mendojnë se kanë kapacitete të forta dhe ku nevojitet zhvillim i mëtejshëm i kapaciteteve të tyre?
- Cilat janë partneritetet e ndryshme dhe rrjetet kombëtarë e ndërkombëtarë ku ato bëjnë pjesë (sipas fushave specifike që mbulojnë)?
- Cilat janë hapat për ri-orientimin e fokusit në rritje të OShCR-ve drejt zhvillimit rural?

3.2. Përqasja metodologjike

Studimi për identifikim dhe vlerësim të OShC-ve në zonat rurale dhe periferike përdor një qasje metodologjike të përzier për vlerësimin e prezencës, veprimtarive dhe nevojave të shoqërisë civile në zonat rurale të qarqeve Berat, Gjirokastër, Elbasan dhe Lezhë. Për trajtimin e pyetjeve kërkimore të listuara më sipër studimi përdor një kombinim të teknikave të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave sasiore me ato cilësore. Teknikat e përdorura për kryerjen e këtij studimi përfshijnë sa më poshtë vijon:

Rishikimi i burimeve

Ekipi kërkimor mbledhi dhe përdori një gamë të gjerë dokumentesh të ndryshëm që përmbanin informacion mbi historinë dhe situatën aktuale të shoqërisë civile në zonat urbane dhe rurale të Shqipërisë. Pjesë e dokumenteve të rishikuara ishin raportet studimore për shoqërinë civile në Shqipëri, raportet për veprimtari nga grupe të ndryshëm OShC dhe nga rrjete të ndryshëm, lista dhe statistika për OShC-të shqiptare, manuale dhe dokumente përkatës trajnues si edhe materiale të ndryshme referencash nga interneti.

Vëmendje e veçantë iu kushtua raporteve të mëparshëm për sektorin e shoqërisë civile në zonat rurale në përgjithësi si edhe në zonat e synuara nga projekti (qarqet Berat, Elbasan, Gjirokastër dhe Lezhë) në veçanti.

Rishikimi i dokumenteve të qeverisjes dhe institucioneve vendorë si edhe i raporteve dhe statistikave për veprimtaritë e OShC-ve dhe nevojat e tyre në fushat specifike ku ato veprojnë mundësoi informacion mbi specifikat e zonave të synuara dhe krijoi terrenin e përshtatshëm për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave sasiore dhe cilësore.

Intervista të thelluara me informatorët kyç

Intervista të thelluara u zhvilluar me informatorët kyç me qëllim eksplorimin e situatës aktuale të ShC-së në zonat rurale dhe periferike të qarqeve të përzgjedhur. Intervistat nxorën në pah informacion për nivelin e aktivizmit të ShC-së rurale, për njohuritë që ajo ka mbi rrolin që duhet të luajë në komunitet dhe në sistemin e qeverisjes vendore, për llojet e nismave/veprimtarive ekzistuese në zonat relevante, për sfidat dhe nevojat specifike me të cilat përballet përgjatë implementimit të veprimtarive të saj, për pikat e forta dhe ato të dobëta, si edhe për ato të cilat perceptohen prej aktorëve të saj si ‘hapat e ardhshëm’ për ri-orientimin e OShCR-ve drejt rritjes së fokusit rural në kuadër të zhvillimit dhe sfidave të integritimit.

Informatorët kyç përbëheshin nga përfaqësues të OShC-ve, udhëheqës vendorë, përfaqësues të medias dhe të qeverisë dhe përfaqësues të institucioneve vendorë. Intervistat e thelluara shërbyen gjithashtu edhe si mjet për identifikimin e aktorëve kryesorë lokalë dhe të tematikave të analizës që do të mbuloheshin prej pyetësorit përgjatë fazës vijuese të projektit. Ky instrument u përdor në dy stade të procesit të vlerësimit të nevojave. Më konkretisht, në fillim të vlerësimit, duke synuar identifikimin e problematikave dhe në fund të tij (pas sondazhit dhe grupeve të fokusuara) me synim qartësimin e prirjave dhe validimin e tyre.

Sondazhi

Një mini-sondazh u zhvillua me aktorët kryesorë vendorë për të përcaktuar nevojat dhe mundësitë për zhvillimin e ShC-së në zonat e synuara. Pyetësori i sondazhit synoi kryesisht përfaqësues të OShC-ve rurale (grupet përfitues të të cilave ishin kryesisht gratë, të rinjtë, komuniteti Rom, moshat e thyera, etj.), si dhe përfaqësues nga media dhe përfaqësues të qeverisjes vendore. Grupi i pyetjeve u zhvillua bazuar në objektivat specifike të projektit si edhe në gjetjet e gjeneruara nga intervistat e thelluara me informatorët kyç.

Kampioni

Ndërkohë që fillimisht sondazhi tentoi të përfshijë një total prej rreth 400 organizatash të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë vendorë në të katër

qarqet e targetuara (Berat, Elbasan, Lezhë dhe Gjirokastrë), kufizimet e ndryshme të punës në terren dhe shtrirjes gjeografike dhe tematike të OShC-ve në këto zona imponuan nevojën e ri-përkufizimit të metodologjisë dhe kampionimit. Kjo nevojë u bë e qartë që në fazat e para të vlerësimit, më konkretisht në kuadër të intervistave paraprake me “informatorët kyç” të cilat i paraprinë finalizimit të projekt-metodologjisë. Rrjedhimisht, duke synuar një mbulim sa më të gjerë jo vetëm gjeografik por gjithashtu edhe tematik dhe sektorial në katër zonat e targetuara, studimi përfshiu rreth 220 të anketuar në kuadër të analizës sasiore të informacionit dhe rreth 150 aktorë të tjerë të shoqërisë civile, sektorit privat, medias dhe pushtetit vendor në kuadër të veprimtarive që synojnë analizën cilësore të informacionit (fokus grupe, intervista të strukturuar etj). Kjo zgjedhje mundësoi një bazë të dhënash më të plotë dhe të thelluar në kuadër të mbledhjes së të dhënave në terren.

Diskutimet në fokus-grupe

Diskutimet në Fokus-Grupe (FG) u organizuan me grupe të komunitetit të mbështetur nga OShC-të në zona të ndryshme për të testuar vlefshmërinë e gjetjeve që dolën nga pyetësi dhe intervistat e thelluara. Zgjedhja e pjesëmarrësve u bazua mbi kriterin e përfituesve relevantë. Këta u organizuan në grupe diskutimi prej 8-12 personash bazuar në tematikat e ndryshme që u adresuan gjatë procesit të vlerësimit (duke përfshirë gjetjet e pyetësit dhe ato të intervistave të thelluara). Për secilën nga zonat e synuara u organizuan dy diskutime në FG duke arritur një total prej 8 FG me mbi 60 pjesëmarrës.

Analiza e të dhënave

Përgjatë seksioneve në vazhdim të këtij raporti vlerësimi, do të prezantohen dhe diskutohen gjetjet nga analizimi i të dhënave sasiore dhe atyre cilësore. Të dhënat e mbledhura nga metodat sasiore u analizuan së pari duke koduar përgjigjet sipas fushave përkatëse të interesit, duke krahasuar dhe kontrastuar. Analiza përqendrohet gjithashtu edhe tek identifikimi i ndryshimeve ndërmjet OShC-ve të vendosura dhe që veprojnë në zonat rurale dhe periferike dhe OShC-ve të vendosura dhe që veprojnë në qendrat kryesore ekonomike dhe urbane. Të dhënat e mbledhura nga pyetësi u analizuan duke përdorur programe statistikore për shkencat shoqërore dhe gjetjet (në seksionet në vijim) prezantohen kryesisht nëpërmjet grafikëve dhe tabelave të frekuencave dhe përqindjeve. Në raste të veçanta me interes për pyetjet kërkimore dhe objektivat përkatës të këtij studimi, janë kryer gjithashtu eksplorime të mëtejshme me anë të krostabulimeve.

4. ANALIZA E TË DHËNAVE CILËSORE

4.1. Përfshirja dhe zhvillimi i shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike

Pavarësisht listave të gjata me emra organizatash jo-qeveritare të regjistruara në zona të ndryshme të Shqipërisë (përfshi zonat e studimit tonë: Gjirokastrë, Berat, Elbasan dhe Lezhë) identifikimi i organizatave aktive në zonat rurale dhe periferike rezultoi një sfidë. Gjithsesi, deri diku e pritshme! Një numër tejet i kufizuar organizatash jo-qeveritare kanë veprimtarinë e tyre të shtrirë në zonat rurale dhe periferike dhe akoma më pak ekskluzivisht të fokusuara në këto zona. Madje edhe midis tyre, përvojat në terren rezultonin të pakta dhe kryesisht në formën e projekteve pilote apo bija të projekteve të mëdha në nivel rajoni apo kombëtar. Po përtej kësaj, disa prire mund të identifikohen nga përshkrimet e historikëve të këtyre përfaqësuesve të organizatave jo-qeveritare me një lidhje apo shtrirje të punës së tyre në zonat rurale dhe/ose periferike.

Shumica e organizatave rezultojnë të jenë krijuar në periudhën nga fillimet e viteve '90 deri në fillimet e viteve 2000. Dekada e fundit, ndryshe nga sa mund të pritej për një zhvillim të mëtejshëm të shoqërisë civile në këto zona, rezulton të ketë qenë e përgjumur. Motivet e krijimit të këtyre organizatave me veprimtari në zonat rurale/periferike lidhen kryesisht me çështje të mjedisit, ruajtjes së kulturës e traditës, nxitjen e turizmit apo edhe kapërcimi i situatave emergjente të tipit fatkeqësi natyrore apo diçka tjetër e ngjashme. Pak prej tyre janë nxitur apo edhe krijuar si pasojë e nevojave dhe presionit të grupeve të caktuara të interesit. Megjithatë, organizatat e krijuara pas viteve 2000 ndonëse më të pakta në numër rezultojnë më të qarta në mision dhe vizionin e tyre dhe me lidhje më të forta me komunitetin dhe grupet e interesit që përpiqen të përfaqësojnë. Tipike janë shoqatat e profesionistëve të ndryshëm ato të biznesit apo fermerëve. Gjithsesi, mbeten të pamjaftueshme për të trajtuar problematikat e shumta rurale/periferike.

Varfëria e shoqërisë civile në zonat rurale/periferike tregohet edhe në shtrirjen e atyre pak organizatave që operojnë aty. Ato kanë shtrirje

të vogël gjeografike dhe shpesh veprimtarie i tyre nuk pasqyron shumë nga problematika e zonës ku aplikohet apo nuk ka si qëllim primar, të drejtpërdrejtë zhvillimin e saj. Një pjesë e organizatave mund t'i veshin vetes profilin e një organizate rurale edhe pse operojnë kryesisht në zonat urbane dhe veprimtaritë e tyre në zona rurale mund të kenë qenë thjesht sporadike apo edhe rastësore.

Ndërkohë intervistat cilësore me përfaqësues të sektorit të shoqërisë civile evidentojnë një larmishmëri për sa i përket përvojave nga një zonë në një tjetër. Kjo bëhet e dukshme në përgjigjet që ata japin lidhur me diferencat që ndojnë midis veprimtarisë në zona rurale/periferike dhe në ato urbane. Linjat e përbashkëta lidhen me vështirësitë dhe sfidat e punës në zonat rurale/periferike si ato që kanë të bëjnë me financimin e kufizuar, infrastrukturën e varfër, mungesën e besimit nga komuniteti apo/ dhe pushteti vendor, si dhe perspektivën dhe garancinë për vazhdimësi.

“Një OJF në zonën urbane ka një spektër të gjerë veprimi dhe funksionimi, shpesh duke përfshirë dhe atë rurale. OJF-të vendore veprimtarinë e tyre e kanë të lokalizuar vetëm në zonën rurale ku janë lokalizuar. OJF-të urbane kanë më shumë mundësi financimi dhe ekspozimi ndaj financuesëve të ndryshëm, kanë ndoshta dhe burime njerëzore me kapacitete më të larta.”

(Qarku Elbasan)

“Mendoj se është një ndryshim i madh... puna e drejtpërdrejtë me aktorët përfshirës në projekt është më e vështirë, por gjithashtu që sjell edhe më shumë përfitime për sa i përket lidhjes që krijohet me ta. Besimi është një nga sfidat dhe vështirësia më kryesore në punën tonë dhe që të arrish ta krijosh, e vetmja mënyrë është të jesh në kontakt të drejtpërdrejtë me ta”.

(Qarku Gjirokastrë)

Dallimet në vështirësitë e përmendura vijnë edhe si rezultat i natyrës së punës së organizatave. Për shembull, organizatat që ofrojnë shërbime për gratë përballen me sfida të ndryshme nga ato që punojnë për mjedisin.

“Dallimi është se në zonat rurale mungojnë ambientet e këshillimit dhe punonjësit socialë, ndeshemi me papunësinë dhe një mentalitet që nuk i bën gratë shumë të gatshme të bashkëpunojnë, ndërkohë që në zonat urbane këto probleme janë më pak të theksuara.”

(Qarku Berat)

“Krahasuar me zonat urbane ne kemi më pak mundësi për thithje fondesh. Sfidat tona janë të ndryshme; po përmend se ka një mungesë ligjore për pyjet dhe shfrytëzimin tyre, çka vështirëson dhe punën tonë. Komuniteti nuk e ka kuptuar mire rolin ndërgjegjëses të shoqatës dhe komuna nuk na përkrah ekonomikisht.

(Qarku Elbasan)

Interesante është edhe mënyra sesi të intervistuarit identifikojnë vështirësi apo pengesa që ndonëse vijnë nga përvoja të nivelit vendor e kanë burimin në kuadrin ligjor për shoqërinë civile në Shqipëri. Trajtimi i tyre njëlloj si bizneset perceptohet si një padrejtësi që i bëhet sektorit të shoqërisë civile.

“Sfidat dhe vështirësitë e hasura për organizatën tonë kanë qenë gjetja në mënyrë të vazhdueshme e fondeve , nuk kemi mjete logjistike për të realizuar lëvizjet në të gjithë qarkun, dhe sigurisht që mbetet ende sfida për ne ligji ekzistues për shoqatat, pasi ne trajtohem jo si shoqata jo-fitim prurëse, por si biznese, pa pasur asnjë lehtësi në taksa dhe veprimtarinë fiskale.”

(Qarku Elbasan)

Megjithatë, puna në zonat rurale/periferike nuk ka vetëm sfida dhe vështirësi, por edhe avantazhe në raport me atë në zonat urbane. Të qenit më pranë grupeve të interesit dhe mundësia për komunikim të drejtpërdrejtë vlerësohen si një mundësi për më tepër sukses dhe impakt. Po kështu ndryshimet që sjell puna e këtyre organizatave në këto zona të vogla behët më e ndjeshme, konkrete dhe e prekshme, cilësi që ndikojnë drejtpërdrejt edhe në përforcimin e besimit midis tre partnerëve organizata – komunitet – pushtet vendor.

“Në zonat rurale përfitimi është i drejtpërdrejtë tek fermeri, megjithëse nuk ka shumë impenjim (duke qenë se fitimi është i ulët) në ndryshim nga zonat urbane ku ka shumë burokraci dhe më shumë teori”.

(Qarku Lezhë)

Edhe pse identifikimi i vështirësive dhe sfidave rezulton deri diku i lehtë për të intervistuarit, ka pak qartësi në mendimet dhe përgjigjet e tyre për sa i përket mbulimit dhe shtrirjes së misionit dhe veprimtarisë të tyre. Ndoshta nevoja për të mbijetuar pavarësisht vështirësive të sipërpërmendura i detyron një pjesë të mos jenë qartësisht të fokusuar në misionin dhe veprimtarinë e punës së tyre duke përfshirë në të një larmishmëri qëllimesh, objektivash, veprimtarish dhe përfituesish. Mbulimi gjeografik, llojet e veprimtarive dhe grupet e synuara variojnë shpesh sipas projekteve apo donacioneve të vlefshme duke krijuar jo rrallëherë një mozaik që mund të rrisë mosbesimin tek grupet e interesit apo komuniteti në përgjithësi.

Siç shprehen edhe vetë të intervistuarit, një nga sfidat më të mëdha është pikërisht ajo që ata e cilësojnë si “mentalitet” të komunitetit kundrejt shoqërisë civile.

“Stafi i shoqatës në vetvete e kupton rolin e shoqatës, por në komunitet ka ende mentalitete negative për veprimtarinë tonë, janë ende të paedukuar për veprimtarinë e shoqatës. Shpesh ka konflikt mendimi

midis OJF dhe komunitetit për sa i përket buxhetimeve dhe përdorimit të fondeve”.

(Qarku Elbasan)

Mundësitë e kufizuara që këto organizata kanë pasur fajësohen deri diku edhe për këtë prezencë të kufizuar dhe marrëdhënie jo shumë solide dhe pozitive me komunitetet në këto zona. Duke pasur pak burime financiare, edhe veprimtaritë kanë qenë më të pakta e për pasojë lidhja me komunitetin edhe më e dobët.

“Punojmë me miniprojekte, me shuma simbolike, të cilat i marrim me shumë vështirësi dhe jemi shumë të kënaqur, ndërsa OJF-të e zonave urbane, sidomos Tirana, na huton me fondet që marrin, njerëzit e stafet e punësuar.”

(Qarku Gjirokastrë)

Por nga ana tjetër edhe informimi dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve rurale e periferike është vendimtar në mbështetjen që ata do i japin apo jo shoqërisë civile dhe aktorëve të saj. Ai nuk mund të ndryshojë shpejt dhe pa shumë përpjekje. Përkundrazi, kërkohet shumë punë nga vetë aktorët e shoqërisë civile për ta ndërgjegjësuar atë, por sidomos për t'i treguar me vepra dobinë që ato kanë për ta dhe zhvillimin e zonës ku ata jetojnë.

“Mentaliteti i zonave ku punojmë është sfidë. Theksojmë se nuk e kuptojnë këshillimin ose ndihmën. Sfidë ka qenë përfshirja e grave në veprimtari dhe takime konsultative”.

(Qarku Elbasan)

“Për sa i përket komuniteteve vendore ka akoma punë për të bërë pasi nuk e kuptojnë rëndësinë e kësaj pune dhe nuk ndihmojnë në realizimin në veprimtarive”.

(Qarku Elbasan)

4.2. Njohuritë dhe kapacitetet e shoqërisë civile në zonat rurale/ periferike

OFJ me veprimtari në zonat rurale/periferike raportojnë për pak mbështetje dhe burime. Kufizimet në fonde pasqyrohen shpesh edhe në kufizime në infrastrukturë dhe kapacitete. Përgjithësisht pretendohet se shumica e punës bëhet vullnetarisht dhe stafi me kohë të plotë është mjaft i kufizuar, ndonëse sipas tyre mjaftueshëm i kualifikuar. Gjithsesi, trajnimet dhe kualifikimet e mëtejshme vlerësohen si mjaft të nevojshme. Ka veçanërisht nevojë për ngritje të kapaciteteve në drejtim të shkrimit të projekteve dhe ngritjes së fondeve, pasi, siç pohojnë edhe vetë ata, trajnimet dhe veprimtaritë për ngritjen e kapaciteteve në përgjithësi kanë ardhur në rënie.

“Përveç financimeve që nuk diskutohen që kemi shumë nevojë, kemi nevojë edhe për trajnime për sa i përket shkrimit të projekteve”.

(Qarku Elbasan)

“Kanë bërë disa trajnime nga shoqatat qendrore, por këto 4 -5 vitet e fundit edhe ato janë harruar. Është një staf që s’gjen terren për të punuar dhe tërhiqet”.

(Qarku Gjirokastrë)

Pak informacion gjenerohet në raport me vetë-perceptimin e aktorëve të shoqërisë civile lidhur me rolin që aktualisht kanë apo atë që besojnë se duhet të luajnë në të ardhmen. Ndërkohë, ato pak perceptime që ata ndajnë mbi imazhin që organizatat e shoqërisë civile kanë në komunitet dëshmojnë se në këtë drejtim mbetet ende shumë për t’u bërë për të qartësuar dhe përmirësuar imazhin e shoqërisë civile dhe aktorëve të saj në këto zona.

“Besoj se po. Gjithsesi, OJF-të duhet të prekin nga afër problemet e komunitetit dhe të punojnë më fort.”

(Qarku Berat)

“Nuk janë shumë të ndërgjegjshëm për rolin që kanë pasi më shumë punojnë në zyrë se në terren, edhe pse interesi i fermerëve s’mungon”.

(Qarku Lezhë)

4.3. Përvojat e deritanishme

Pavarësisht traditës dhe historikut të shkurtër të zhvillimit të shoqërisë civile në zonat rurale/periferike dhe vështirësive të hasura, të intervistuarit sigurisht që janë në gjendje të listojnë edhe arritje dhe suksese të punës së tyre, të cilat shkojnë nga ndryshime të vogla në sipërmarrje të mëdha në nivel strategjie rajonale.

“Disa nga arritjet tona janë produkti i mjaltit i certifikuar nga HCCP dhe ISO9001 norma të BE-së që sigurojnë një treg brenda dhe jashtë vendit dhe gjithashtu edhe mundësia që kanë fermerët për të trajtuar patologjitë e bletës me produkt Bio, të njëjtë me standardet e BE-së.”

(Qarku Lezhë)

“Në vitin 2009 menaxhuam një projekt për Ujërat Termale të Bënjës, 7 km larg qytetit. Ndërgjegjësuam komunitetin për vlerat kurative të këtyre burimeve, pasuruam mjedisin me mbjelljen e disa pemëve dekorative, pastruam basenet dhe i rregulluam ata, vendosëm tabela orientuese etj. Kjo gjë solli shtimin e numrit të vizitorëve.”

(Qarku Gjirokastrë)

“Në qarkun e Elbasanit nuk ka pas strategji të uljes së ndotjes urbane. Kjo u realizua si një bashkëpunim i suksesshëm me Qarkun e Elbasanit dhe pjesëmarrjen e publikut për një periudhë prej 2 vjetësh. Kjo është shënuar si sukses i organizatës tonë.”

(Qarku Elbasan)

Pavarësisht vështirësive, përpjekjeve dhe shpesh edhe mungesës së shpërblimit, janë pikërisht sukseset e arritura dhe sjellja e ndryshimit në jetën e banorëve të këtyre zonave që i bën stafet e këtyre organizatave krenarë dhe të motivuar për ta vazhduar punën e tyre edhe në të ardhmen.

“Një grua nga një zonë rurale pasi mbaroi kursin si ndihmës infermiere tek ne (vijnë nga një zonë e largët) vazhdoi më pas studimet e larta në infermieri dhe tashmë është e punësuar. Tri gra që kanë marrë patentën e makinës në sajë të ndihmës sonë kanë hapur më pas bizneset e tyre. Edhe gratë që mbarojnë kursin e rrobaqepësisë kanë hapur bizneset e tyre në fshat.”

(Qarku Elbasan)

Këto suksese të arritura sigurisht që ndihmojnë dhe kanë kontribuar në një njohje më të madhe nga ana e komunitetit si dhe në krijimin e një marrëdhënie besimi midis këtij të fundit dhe aktorëve të veçantë të shoqërisë civile, besim në potencialet dhe rolin ata që mund të luajnë edhe në të ardhmen. Është pikërisht ky besim në rritje i komunitetit që shpesh cilësohet si një sukses në vetvete.

4.4. Nevojat dhe sfidat

Kur flitet për nevojat dhe sfidat më të mëdha me të cilat ndeshet shoqëria civile në zonat rurale, nevoja e parë (dhe mbase edhe më imediate), rezulton pikërisht ngritja e kapaciteti për të njohur vetveten, përfshi nevojat. Disa nga nevojat që listojnë të pyeturit janë:

- Pasurimi stafit me elemente të rinj dhe trajnimi i tyre me informacionin bashkëkohor
- Pasurimi i infrastrukturës së punës me mjete me bashkëkohore (laptop, video-projektor, etj.)
- Pajisja me laboratorë dhe mjete të tjera pune
- Sigurimi i partneritetit me administratën vendore, por edhe me OJF simotra brenda e jashtë vendit

Kur të intervistuarve u kërkohet të identifikojnë pikat e tyre të dobëta, ata janë në gjendje të përmendin kryesisht kërcënime që iu kanosen atyre dhe veprimtarisë që kryejnë dhe vetëm në pak raste pika të dobëta që lidhet drejtpërdrejt me organizatën e tyre dhe elemente që varen prej saj.

“Nuk jem shumë këmbëngulë, tërhiqemi para pengesave, indiferentizmit, dhe nuk duam të krijojmë konflikte me pushtetin lokal ... Shumicën e veprimtarive i ndërtojmë në planin sensibilizues, dhe pak në atë praktik që të mbetet diçka nga puna jonë, që të jetë e prekshme dhe jetëgjatë. Por kjo edhe për specifika fondesh.

(Qarku Gjirokastër)

“Punë e dobët në promovimin e shoqatës sonë dhe veprimtarive të saj si dhe mosnjohje dhe mosbashkëpunim me OJF-të e tjera në Elbasan.

(Qarku Elbasan)

Përveç mungesës së infrastrukturës, mjediseve, bashkëpunimeve të dobëta apo indiferencës së pushtetit vendor për organizatat që punojnë në zonat rurale/periferike problemet shtohen edhe nga kuadri ligjor ekzistues. Sipas tyre, legjislacioni në fuqi nuk ua lehtëson punën, përkundrazi ata ndihen të penalizuar.

“Legjislacioni ekzistues për OJF nuk është favorizues për ne në ngritjen e fondeve, madje është denigrues . Ai duhet të ndryshojë dhe të jetë mbështetës për shoqërinë civile dhe jo ta shohë si konkurrente atë krahasuar me biznesin”.

(Qarku Elbasan)

Një pjesë e tyre duhet të luftojnë edhe me imazhin jo pozitiv që mund të kenë krijuar aktorë të tjerë të shoqërisë civile të angazhuar më herët në këto zona. Puna e tyre e dobët apo abuzimi me fondet mund të ketë dëmtuar seriozisht besimin e komunitetin tek aktorët e shoqërisë civile. Kjo për të ardhur keq, por ndërkohë edhe për t'u shënuar si një përparësi për të ardhmen për t'u përmirësuar.

“E kemi problem mosbesimin që kanë grupet e targetuara duke u bazuar në praktika jo pozitive të mëparshme të tyre me organizata të tjera.”

(Qarku Lezhë)

“Pikë të dobët shohim një mospërkrahje të plotë nga pushteti vendor, por edhe në komunitet”.

(Qarku Elbasan)

Nevojë për përmirësim të ndjeshëm kanë edhe marrëdhëniet shoqëri civile – pushtet lokal në zonat rurale/periferike. Kjo marrëdhënie, mesa raportohet, deri tani rezulton të ketë qenë e dobët e në disa raste deri në armiqësore. Për këtë nuk shpëton pa u fajësuar edhe politika. Politizimi i skajshëm i jetës në zonat rurale e periferike e vështirëson më tej këtë marrëdhënie, që të paktën parimisht duhet të ishte krejt tjetër.

“Ka një indiferentizëm e pengesa që krijohen nga pushteti lokal dhe nga administrata për të marrë informacion në lidhje me punën e këshillit, Bashkisë, komunës e kështu me radhë, se kërkojnë vetëm t'i lavdërosh e jo t'u hapësh probleme”

(Qarku Gjirokastrë)

“Politizimi i skajshëm i jetës qytetare dhe dekurajimi që na bën në politika për të na zhvlehtësuar. Kjo gjë pasqyron pastaj edhe në marrëdhënien me qytetarët, qytet e fshat. Edhe pse ne kemi qëndruar larg politikës dhe angazhimeve politike lokale.”

(Qarku Gjirokastrë)

Duke punuar në komunitete të vogla, marrëdhënia e drejtpërdrejtë me banorët dhe njohja e mirë e zonës përbëjnë gjithsesi avantazh. Edhe pikat e forta që identifikojnë të pyeturit e kanë bazën pikërisht në këtë lloj afrimiteti midis stafeve të organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve ku ata punojnë.

“Ana e fortë janë njohja e territorit duke qene se punojmë për një kohë të gjatë në zonë, përvoja, besimi që kemi krijuar ne komunitet.”

(Qarku Gjirokastrë)

Megjithatë, mentaliteti dhe besimi i komunitetit mbeten ende sfidues për arsyet që u përmendën edhe më sipër.

“Mentaliteti, apatia e qytetarëve, kriza e besimit të individit, mungesa punës vullnetare, mungesa e ambienteve në qendrat e komunave.”

(Qarku Berat)

“Paragjykimi që shfaqet për drejtuesit e shoqërisë civile të cilët i quajnë persona korruptivë”

(Qarku Gjirokastrë)

Ndërkohë, shoqëria civile në këto zona ndihet e fortë për sa i përket kapaciteteve njerëzore. Ajo shpreson në një mbështetje më të madhe nga komuniteti i donatorëve. Përfaqësuesit e pyetur besojnë se fakti i të qenit organizata të vogla në zona rurale e periferike i penalizon ata.

“Si pika të forta shikojmë burimet njerëzore aktuale që janë më të mirat e fushës së bletarisë, duke përfshirë edhe Doktor Shkencash dhe që njëkohësisht besojnë në arritjen e objektivave të shoqatës”.

(Qarku Lezhë)

“Donatorët duhet të jenë më mbështetës për OJF të vogla. Kemi mundësi të kufizuara pasi mungojnë projektet. Dhe në rastet kur shkruajmë projekte nuk na miratohen... shkaku OJF e vogël”.

(Qarku Elbasan)

4.5. Rrjetëzimi dhe bashkëpunimet

Shenjat e një shoqërie civile të dobët në zonat rurale dhe periferike pasqyrohen ndjeshëm edhe në mungesën pothuajse totale të bashkëpunime dhe rrjetëzimeve midis aktorëve të këtij sektori. Po kështu marrëdhëniet me pushtetin vendor, që siç u përshkruan edhe më sipër janë shpesh problematike, mbeten sporadike dhe përgjithësisht të bazuara në vullnete individësh dhe jo praktikash institucionale.

“...Pushteti vendor nuk është gjithmonë bashkëpunues dhe shpesh është pengues, në varësi të interesave.”

(Qarku Gjirokastrë)

Duket të ketë një keq-perceptim apo një mos-ndarje të mirë të roleve dhe përgjegjësi midis tyre pasi të intervistuarit raportojnë edhe për një lloj konkurrence, xhelozie apo edhe armiqësie midis aktorëve të shoqërisë civile dhe pushtetit lokal. Puna e shoqërisë civile shihet si kërcënuese për pushtetin vendor.

“Ne mundohemi të kemi një bashkëpunim efektiv me komunën , por shpesh shihet dhe si një mbivendosje e pushteteve veprimtaria jonë nga ana e komunës. Do të donim të kishim me shumë përkrahje.”

(Qarku Elbasan)

“Ka vështirësi për të vjelë informacion dhe shikohet disi me xhelozë apo edhe me keqdashje nga politika apo pushteti lokal.”

(Qarku Gjirokastrë)

“(Marrëdhëniet)..në dukje janë normale, në përmbajtje formale! Kjo, pasi të zgjedhurit lokalë nuk planifikojnë fonde për këto probleme, nuk kanë as struktura për të lancuar thirrje, për të diskutuar e miratuar projekte, por i ndajnë në mënyrë subjektive dhe shumë herë edhe sipas përkatësive partiake. Nuk ka rregullsi, por spontanitet dhe fondet që japin (kur japin – një herë apo dy herë në vit) i ndajnë subjektivisht.”

(Qarku Gjirokastrë)

Patjetër që vlejnë të theksohen edhe ato pak përvoja të mira që po krijohen si në rastin e Qendrës së Gruas Berat, ku donator i vetëm që prej dy vjetësh është Bashkia Berat. Mbetet të sqarohet se ky është rasti i një organizate me shtrirje veprimtarie në zonat rurale, por me qendër në atë urbane. Edhe rastet e pjesëmarrjes në rrjete të ndryshme vijnë pikërisht nga organizata të këtij profili.

Specifikisht dhe ekskluzivisht për përvojat në zonat rurale duhet të përforcohet mesazhi se kur flitet për bashkëpunime e partneritete ato janë tejet të limituara dhe shpesh me vullnete të dobëta apo unidireksionale. Madje rrjetet me organizata ombrellë shihen edhe si kërcënuese për aktorët e ‘vegjël’ të shoqërisë civile.

“(Marrëdhëniet) Përgjithësisht të njëanshme, d.m.th OJF-të kërkojnë më shumë bashkëpunim dhe partneritet, ndërsa njësitë e qeverisjes vendore kanë ngurrime dhe opinion të gabuar se “OJF-të me projektet e tyre po pasurohen dhe po bëjnë para të madhe!”

(Qarku Gjirokastrë)

“... të hiqet dorë nga shoqatat ombrellë. Të evitohet praktika që fondet të thithen nga qendra e thërrimet të ndahen në OJF-të lokale”

(Qarku Berat)

Pavarësisht se të rralla dhe shpesh edhe të paqëndrueshme dhe jetëshkurtra, rrjetet e shoqërisë civile në zonat rurale/periferike kanë edhe ato histori suksesi, të cilat do të duhet të ndahen dhe përforcohen në të

ardhmen. Ka nevojë të përforcohet pikërisht ai komponent që rezulton t'i bëjë ato më të qëndrueshme në kohë – fokusi specifik dhe konkret i punës dhe i interesit të përbashkët.

“Nismat janë të rralla, por ka të tilla. Mund të përmendim nismën pozitive të bashkëpunimit ndërmjet Shoqatës së Bletarisë, World Vision dhe Heifer Albania ku shoqata mbulon pjesën teknike, WV mbështet fuqizimin e personit, ndërsa HA jep dhurata konkrete në mbështetje të fermerëve.

(Qarku Lezhë)

“Rrjetëzimi për ne është mjet konsolidimi, por edhe mbështetje tek njeri tjetri, pasurimi dhe ndarje e përvojave. Kemi bashkëpunim me shoqatën e Gracenit, Bradasheshit, Gjinarit. Këto janë bashkëpunime të fokusuara në fushën e pyjeve.

(Qarku Elbasan)

4.6. Vazhdimësia dhe ardhmja e shoqërisë civile në zonat rurale/periferike

Për të intervistuarit është tashmë e qartë se nëse dëshirojnë që të kenë vazhdimësi në punën e tyre duhet që pikësëpari sytë t'i kthejnë nga komuniteti lokal dhe pushteti vendor respektiv. Bashkëpunimi midis tyre është vital për vazhdimësinë dhe të ardhmen e sektorit civil, por edhe për zhvillimin e këtyre zonave në përgjithësi.

“Për vazhdimësinë e rëndësishme është mbështetja tek komunitetet lokale dhe në fund vjen edhe mbështetja nga pushteti vendor.”

(Qarku Gjirokastrë)

Për një të ardhme sa më të begatë të shoqërisë civile në zonat rurale e periferike kërkohet edhe një përkushtim më i madh i vetë kësaj të fundit. Dhe kjo nuk është një këshillë apo nxitje e jashtme, por një nevojë që evidentohet nga vetë përfaqësuesit e saj. E për ta bërë realitet këtë, ajo çka posedohet deri tani nuk është e mjaftueshme. Kërkohen ngritje kapacitetesh dhe bashkëpunime e partneritete që do mundësonin të merrej më e mira nga të gjitha oportunitetet përfshi edhe procesin e integritimit Evropian.

“Në të ardhmen) Imagjinoj një shoqëri civile më të përgjegjshme dhe më koshiente për potencialin e saj dhe të hapësirës së saj jetësore.”

(Qarku Berat)

“Shpresojmë të jemi më të fuqishme dhe më aktive sepse besojmë që me avancimin e proceseve integruese të vendit, të kemi më shumë bashkëpunim, partneritet, financime dhe përfitime nga programet komunitare të financuara nga BE”.

(Qarku Gjirokastrë)

Në marrëdhëniet midis OJF-ve, komuniteti dhe pushteti vendor pritet të ndihet patjetër edhe prania e një partneri tjetër shumë të rëndësishëm, por deri tani të munguar - biznesit. Krijimi i këtij partneriteti trepalësh shoqëri civile – pushtet lokal – biznes do të lehtësojë edhe rrugën drejt përfitimeve më të mëdha nga programet e Bashkimit Evropian, siç shpresohet edhe nga të intervistuarit.

Të intervistuarit gjykojnë se ata që do ta përshpejtojnë punën e shoqërisë civile në zonat rurale/periferike janë të rinjtë. Po ashtu pritet edhe një njohje dhe vlerësim i punës së tyre, nëse nevojitet, edhe përmes një lloj kontrolli dhe rankimi të aktorëve të shoqërisë civile sipas zonës dhe kontributit që kanë dhënë për të.

“Shoqatat duhet të jenë më të pranishme në zonat rurale, por njëkohësisht do ishte mirë që të kishte edhe një kontroll për të evidentuar impaktin e projekteve në terren në mënyrë që të behet edhe një formë klasifikimi e OJF-ve, por që natyrisht të bëhet në mënyre korrekte dhe të ndershme, pa njëanshmëri.”

(Qarku Gjirokastrë)

Fushat të cilat pritet të marrin zhvillim janë ato të bujqësisë, blegtorisë dhe agro-turizmi, mjedisit, e pavarësisht se flasim për zona rurale edhe çështjet sociale besohet se do jenë pjesë e pandarë e axhendës së shoqërisë civile në këto zona. Por për një zhvillim më të begatë pritet edhe mbështetja me fonde dhe ngritje kapacitetesh nga strukturat shtetërore në përgjithësi e pushteti vendor në veçanti.

“Nëse do të kemi një mbështetje nga vetë shteti, jo vetëm në financime, por edhe ngritje kapacitetesh do të kemi vazhdimësi në të ardhme. Gjithashtu nëse do të ketë dhe bashkëpunim reciprok dhe do të na shohin jo me syrin e konkurrentit, do të thosha që qëndrueshmëria jonë do të jetë më e sigurt.”

(Qarku Berat)

Një shoqërisë civile e fuqishme në zonat rurale mendohet të kontribuojë në vetë zhvillimin e qëndrueshëm të tyre. Një pjesë e aktorëve janë mjaft të ndërgjegjshëm për rolin që mund të kryejnë dhe mundësitë që mund t'i japin këtyre zonave.

“Gjithashtu, do të thosha që nëse OJF-të në zonat rurale kryejnë si duhet misionin e tyre për të cilin janë krijuar dhe mbështeten me financime, mendoj se dhe vete migrimi në këto zona do të ndërpritet, pasi bujku/fermeri/specialisti nuk do të shohin mundësi të tjera jetese jashtë zonës së tyre, por do t'i kthehen investimeve në zonat ku jetojnë.”

(Qarku Gjirokastrë)

Mundësitë janë aty, ato presin të përdoren. Ndaj e ardhmja, siç shprehen vetë ata është ‘portokalli’ do duhet me shumë punë, përpjekje, bashkëpunim dhe partneritet për të ndezur drita jeshile.

“Të ardhmen e shikoj portokalli. Pas 5 vitesh po ka financime do jemi më të sigurt në punën tonë, më cilësorë dhe më të kualifikuar”.


(Qarku Elbasan)

5. ANALIZA E TË DHËNAVE SASIORE


5.1. Profili pjesëmarrësve në studim

Siç është përshkruar edhe në kampionimin e këtij studimi gjatë paraqitjes së metodologjisë së tij, targeti synonte të përfshinte përfaqësues nga i gjithë spektri i shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike. Së bashku me përfaqësuesit e organizatave jo qeveritare (që rëndom njehsohen me shoqërinë civile në tërësi), në studim u përfshirë edhe përfaqësues të shoqatave të biznesit, përfaqësues të medieve lokale si dhe përfaqësues të organeve të pushteti vendor me qëllim pasjen e një këndvështrimi tjetër nga ajo e vetë aktorëve të shoqërisë civile. Duke pasur parasysh objektivat e studimit, sondazhi u fokusua në një masë më të madhe tek aktorët e shoqërisë civile, ndërkohë që pjesëmarrja e kategorive të tjera rezultoi si më poshtë:


Grafiku 1. Pjesëmarrësit në studim sipas angazhimit të tyre



Pavarësisht vështirësive si pasojë e aktorëve të pakët të shoqërisë civile dhe stafeve të tyre të limituara që veprojnë në këto zona, u synua që pjesë e këtij studimi të ishin jo vetëm drejtues, por edhe anëtarë të stafeve të tyre apo edhe bashkëpunëtorë. Grafiku i mëposhtëm paraqet profilin e pjesëmarrësve sipas pozicioneve të tyre. Për arsyt e mësipërme, ka një avantazh të lehtë të drejtuesve.

Grafiku 2. Përgjigjedhënësit në studim sipas pozicionit

Me një fokus kryesor tek aktorët e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike të qarqeve të përfshira, studimi nënvizon se vetëm një pjesë e vogël e këtyre aktorëve punojnë në këto zona kanë edhe qendrën e tyre të vendosur pranë këtyre zonave/komuniteteve. Siç shihet edhe në grafikun e mëposhtëm, vetëm 20% e pjesëmarrësve në këtë studim vijnë nga zonat rurale, 32% nga qytezat (të cilat deri diku mund të konsiderohen si satelitë periferikë të qendrave urbane të rajoneve të studiuara) dhe mëse 48% janë pjesë e organizatave me qendër në zonat urbane, por me veprimtari dhe njohuri edhe për zhvillimin e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike.

Grafiku 3. Pjesëmarrësit sipas qendrës së punës


Pyetësi i hartuar për këtë sondazh u nda në disa seksione, një pjesë e të cilëve i trajtohej gjithë të anketuarve ndërsa pjesa tjetër vetëm anëtarëve të organizatave të shoqërisë civile. Në vijim parashtrohen gjetjet e identifikuara.

5.2. Vështrim mbi shoqërinë civile në zonat rurale dhe periferike


Një pjesë e rëndësishme e pyetësorit kërkonte të merrte informacion për të krijuar një panoramë të shoqërisë civile në zonat rurale/periferike nga vetë përfaqësuesit e këtij sektori dhe bashkëpunëtorët e tyre në institucionet e pushtetit vendor. Për këtë atyre iu kërkuar të vlerësonin rolin, kontributin dhe impaktin e punës së aktorëve të shoqërisë civile në këto zona.

Nga gjithë përgjigjedhënsit në këtë studim vetëm 23% mendojnë se shoqëria civile në këto zona është shumë aktive (vlerësime 1 dhe 2). Pjesa dërmuese, 87% i japin vlerësimin nga 3-5, ku alternative 5 korrespondon me 'aspak aktive'. Në fakt kjo gjetje mund të mos përbëjë surprizë, pasi siç është komentuar edhe më herët zonat rurale dhe periferike në vend 'vuajnë' nga një shoqëri civile shumë e tkurrur. Sasia mund të jetë përcaktuese edhe në këtë vlerësim që vetë përfaqësuesit e saj bëjnë. Megjithatë, kjo 'notë' për shkallën e veprimtarie të shoqërisë civile në këto zona mund të pasqyrojë edhe pasivitetin apo veprimtarinë e ulët edhe të aktorëve që janë prezent në këto zona.


Grafiku 4. Sa aktive është shoqëria civile në zonat rurale/periferike?



Grafiku 4.1 Opinioni i OJQ-ve




Grafiku 4.2 Pjesa tjetër e të anketuarve




Shkalla e veprimtarisë të shoqërisë civile në zonat rurale shihet më me skepticizëm nga vetë aktorët kryesorë të saj siç janë organizatat jo-qeveritare. Vetëm 2% e tyre mendojnë se shoqëria civile në këto zona është shumë aktive krahasuar me 7% të pjesës tjetër të të pyeturve, përfaqësues të medias apo pushtetit vendor. Më tepër sesa për nota pesimiste, këtu mund të aludohet për një shkallë më të lartë njohje të veprimtarisë dhe rolit që shoqëria civile luan në këto zona nga vetë përfaqësuesit e saj. Gjithsesi, diferenca më e ndjeshme vihet re në ekstremin tjetër të vlerësimit, atë negativ. Siç shihet qartë, alternativën 5 (aspak aktive), e zgjedhin 33% e përfaqësuesve të medias dhe pushtetit vendor përkundrajt 4% të përfaqësuesve të organizatave jo-qeveritare. Gjë që tregon qartë se pritshmëritë e komunitetit (veçanërisht medias dhe pushtetit vendor) në zonat rurale mbeten në një pjesë të madhe të paplotësuar.

Arsyeja e dytë e një note të ulët për veprimtarinë e shoqërisë civile në zonat rurale duket se përforcohet edhe nga përgjigjja që merr pyetja lidhur me impaktin e punës së shoqërisë civile në këto zona. Pjesa më e madhe e vlerësojnë punën e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike nga pak në aspak ndikuese (alternativat 3-5). Vetëm 22% e tyre e vlerësojnë pozitivisht impaktin e saj. Po kështu 71% e të pyeturve besojnë se shoqëria civile në zonat rurale e periferike trajton vetëm pjesërisht nevojat e këtyre zonave dhe 24% mendojnë se veprimtarie i saj është i shkëputur nga realiteti dhe nuk trajton aspak këto nevoja.

Grafiku 5. Sa ndikon puna e shoqërisë civile në këto zona?



Grafiku 6. Sa i plotëson shoqëria civile nevojat e komuniteteve në zonat rurale/periferike?



Trendi i një vlerësimi më kritik për punën e shoqërisë civile nga përfaqësuesit medias dhe pushtetit vendor vazhdon të shfaqet edhe në vlerësimin e ndikimit të punës së shoqërisë civile në këto zona. Ashtu si edhe në vlerësimin e veprimtarisë të shoqërisë civile edhe në vlerësimin e impaktit të punës së saj, rezultatet e përgjithshme anojnë drejt një vlerësimi të ulët, si në grafikun 5. Gjithsesi, Tabela 1, bën të qartë diferencimin midis dy nënkategorive, ku media e pushteti vendor në 33% të rasteve e vlerëson nul ndikimin e punës së shoqërisë civile përkundrejt 5% të përfaqësuesve të organizatave jo-qeveritare. Kjo e fundit, ndonëse një shifër e ulët, shumë domethënëse kur vjen nga aktorët kryesor të punës së shoqërisë civile në këto zona.

Si do ta vlerësonit ndikimin e punës së shoqërisë civile në komunitetin ku punoni në një shkallë nga 1 (shumë) në 5 (aspak)?	OJQ-të (në %)	Pjesa tjetër: media dhe pushteti vendor (në %)
1 (shumë)	2	7
2	29	13
3	32	20
4	32	27
5 (aspak)	5	33

Më të ngjashëm në përgjigjet e tyre këto dy nëngrupe shfaqen në vlerësimin e nivelit me të cilin shoqëria civile i plotëson nevojat e komunitetit (si në tabelën në vijim). Megjithatë, ky vlerësim varjon edhe në bazë të çështjeve apo nevojave të veçanta. Më poshtë renditen fushat apo nevojat

që mendohet të jenë trajtuar më shumë dhe më pak nga shoqëria civile në zonat rurale/periferike.

Sa i plotëson shoqëria civile nevojat e komuniteteve në zonat rurale/periferike?	OJQ-të (në %)	Pjesa tjetër: media dhe pushteti vendor (në %)
Plotësisht	5	2
Pjesërisht	69	75
Aspak	25	23
Nuk e di	1	0

Ndër çështjet dhe problematikat që mendohet se shoqëria civile në zonat rurale dhe periferike ka punuar më mirë përmenden:

- Çështje që lidhen me advokacinë dhe lobimin për grupe të caktuara interesi apo për zonën në tërësi
- Puna për të drejtat e grave dhe fëmijëve (përfshi kategori të veçanta të tyre si p.sh gratë e dhunuara, fëmijët me probleme zhvillimi etj);
- Ruajtja dhe promovimi i kulturës, traditës dhe zakoneve të zonave ku punohet;
- Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i turizmit (kulturor dhe mjedisor);
- Promovimi i grupeve të ndryshme profesionale (p.sh fermerëve, gazetarëve lokalë etj.)


Më opinion e tyre është bërë pak ose aspak për të trajtuar një sërë problemesh të tjera që ata vetë i përshkruajnë si nevojë për:

- Vende të reja pune;
- Projekte për zhvillimin e bujqësisë si dhe për zhvillimin e blegtorisë
- Zhvillimin i infrastrukturës së zonës (p.sh për rruge, sisteme për ujitjen e tokave etj.)
- Ndërgjegjësimin e komunitetit, inkurajimin e vullnetarizmit dhe punës në komunitet,
- Pjesëmarrjen më të madhe të grave në jetën komunitare, politikëbërje etj.
- Rritjen e bashkëpunimi ndër-institucional;
- Mbrojtjen e të drejtave të minoritetit;
- Çështjet sociale në përgjithësi dhe njerëzit me aftësi të kufizuara dhe shërbimi shëndetësor e arsimor në veçanti.


Pjesë e mostrajtitimit të mirë të disa prej çështjeve që edhe vetë pjesëmarrësit në studim identifikojnë janë edhe ato që lidhen me të drejtat e grave dhe minoriteteve. Rezulton se shoqëria civile në këto zona është

ende larg një përfaqësimi dhe trajtimi të mirë të çështjeve të minoriteteve dhe grave. Të parat besohet se trajtohen pjesërisht, pasi 50% e të pyeturve zgjedhin këtë alternativë dhe ato të grave 58%.

Grafiku 7. Përfaqësimi dhe trajtimi i çështjeve të minoriteteve



Grafiku 8. Përfaqësimi dhe trajtimi i çështjeve të grave




5.3. Shoqëria civile dhe mjedisi rural/periferik

Suksesi apo mospjesëmarrje në këto zona varet si nga faktorë që mund të kontrollohen prej vetë asaj, ashtu edhe nga faktorë të cilët lidhen me kontekstin, komunitetet ku punojnë dhe mjedisin rural/periferik në përgjithësi. Në këtë prizëm, puna e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike rezulton të vlerësohet si me më shumë sfida dhe vështirësi sesa ajo në zonat urbane. Kjo duke filluar që nga lehtësia me të cilën mund të themelohet një organizatë apo shoqatë në këto zona respektive. Gati tre të katërtat e të gjithë pjesëmarrësve (74% e tyre) shprehen se është më e vështirë të nisësh një veprimtari të tillë në zonat rurale dhe vetëm 18% mendojnë se nuk ka ndonjë diferencë midis zonave urbane dhe atyre rurale.


(siç tregohet edhe në grafikun e mëposhtëm).

Grafiku 9. Më e lehtë të themelosh një organizatë në zonat urbane apo rurale?



Pikë së pari, mjedisi rural e periferik në tërësi cilësohet si përgjithësisht jo shumë miqësor dhe mbështetës ndaj aktorëve të shoqërisë civile. Madje 10% e të pyeturve mendojnë se ai është 'totalisht pengues' e vetëm 1% mendojnë se ai është 'totalisht mbështetës'. Vështirësitë janë të ndryshme; infrastrukturore, të mentalitetit, burimeve etj. Por këto do të eksploroehen më tej. Ajo që mund të vihet re është se këtë atmosferë jo shumë miqësore e perceptojnë dhe e vlerësojnë si të tillë më tepër përfaqësuesit e medias dhe pushtetit vendor (33%) sesa vetë përfaqësuesit e organizatave jo-qeveritare (9%), ndryshe nga sa mund të pritej (Shiko tabelën 3).


Grafiku 10. Sa mbështetës është mjedisi i zonave rurale/periferike?



Si do ta vlerësonit mjedisin rural/periferik në raport me shoqërinë civile dhe veprimtarinë në një shkallë nga 1 në 5?	OJQ-të (në %)	Pjesa tjetër e shoqërisë civile dhe pushteti vendor (në %)
1 (shumë mbështetës/bashkëpunues)	4	7
2	21	13
3	38	20
4	28	27
5 (totalisht pengues)	9	33


Vetë aktivizimi i komuniteteve rurale/periferike dhe grupeve të interesit në to vlerësohet si më i vështirë sesa në zonat urbane. Mbi 70% të pjesëmarrësve në studim mendojnë se komuniteti dhe grupet e interesit janë më aktivë dhe përfshihen më lehtë në veprimtari e shoqërisë civile në zonat urbane. Ndërkohë 16% mendojnë se nuk ka diferenca dhe vetëm 11% se ndodh e kundërta – pra më aktivë në zonat rurale/periferike.

Grafiku 11. Komuniteti/grupet e interesit më aktivë në:



Ky lloj pasiviteti i komuniteti dhe grupeve të interesit kombinohet edhe me një mospërfshirje të tyre në proceset e identifikimit dhe prioritizimit të nevojave për t'u trajtuar nga shoqëria civile në të ardhmen. 27% e pjesëmarrësve në studim shprehen se komuniteti dhe grupet e interesit nuk përfshihen aspak dhe 66% se përfshihen vetëm pjesërisht në proceset e kësaj natyre.


Grafiku 12. Përfshirja e komunitetit në vendosjen e përparësive të shoqërisë civile



A përfshihet komuniteti i zonave rurale në veprimtaritë e shoqërisë civile për vendosjen e përparësive të agjendës së tyre (organizatave të shoqërisë civile):	OJQ-të (në %)	Pjesa tjetër e shoqërisë civile dhe pushteti vendor (në %)
Plotësisht	5	4
Pjesërisht	65	68
Aspak	29	24
Nuk e di / Refuzim	1	4

5.4. Kapacitetet dhe çështjet organizative të shoqërisë civile në zonat rurale/periferike

Motivet që shtyjnë organizimin e grupeve të interesit apo edhe individëve të veçantë të iniciojnë apo bëhen pjesë e organizmave të ndryshëm të shoqërisë civile variojnë në kohë dhe hapësirë. Pavarësisht kësaj, ky studim është përpjekur të identifikojë arsyet kryesore që nxit veprimtarinë e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike duke u kërkuar përgjigjedhënësve të zgjedhin tre motive kryesore. Totali i tyre shfaqet si në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 13. Arsyet e themelimit të organizatës

Tre arsyet kryesore rezultojnë të jenë:

- Nxjtja dhe mbështetja e zhvillimit të zonës;
- Ofrimi i shërbimeve sociale;
- Mbështetja e grupeve të caktuara në komunitet.

Motive që nëse kanë baza të forta dhe përkthen në vizione dhe objektiva për aktorët e shoqërisë civile të këtyre zonave do të përputheshin shumë mirë edhe me nevojat ende të patrajtuara nga shoqëria të cilat vetë të anketuarit i identifikojnë si të tilla.

Zgjidhja e një problemi specifik ka qenë më rrallë një katalizator për aktivizim të aktorëve të shoqërisë civile. Shumë herë më pak organizatat e shoqërisë civile janë krijuar, ndër të tjera, edhe me qëllim ofrimin e ekspertizës të munguar në këto zona.

Pavarësisht arsyeve të themelimit dhe veprimtarie të tyre, shumica e aktorëve të shoqërisë civile në këto zona ballafaqohen dhe nuk kanë ende të zgjidhura çështje elementare të infrastrukturës. Për shembull, gati 8% e tyre nuk kanë asnjë mjet komunikimi. Vetëm 26% e tyre i kanë të gjithë elementët bazë si telefoni, faksi, kompjuteri dhe interneti. Çështja e zyrave mbetet veçanërisht problematike për to.


Vështirësive të shkaktuara nga infrastruktura e dobët fizike i shtohen edhe kufizimet në burime njerëzore dhe financiare. Në pjesën më të madhe të kohës shoqëria civile në zonat rurale e periferike duket se punon vullnetarisht. Të anketuarit raportojnë se mëse 70% e atyre që angazhohen në punët e organizatës/shoqatës së tyre janë vullnetarë. 10-15% e stafit punon me kohë të pjesshme dhe vetëm 15-20% e stafit është i përhershëm dhe me kohë të plotë. Ndryshe nga shoqëria civile në zonat urbane që rezultojnë të jetë e dominuar (në shifra) nga gratë, në zonat rurale ka një balancim diku tek 55% gra me 45% burra të punësuar apo të angazhuar

në punën e shoqërisë civile.


Pjesa dërmuese e stafeve të organizatave të shoqërisë civile në zonat rurale ‘vuajnë’ nga nivelet e dobëta të kualifikimit të stafeve të tyre. Në total, të pyeturit raportojnë për 84% të stafit me arsim të lartë. Vetëm 35% e tyre janë në gjendje të punojnë në gjuhën angleze. Duke pasur parasysh kërkesat e kohës, ky është një kufizim shumë i madh për zhvillimin e tyre, shkrimin e projekteve, ngritjen e fondeve, rrjetëzimet dhe partneritetet rajonale dhe më gjerë. Ngritja e kapaciteteve të tyre për shkrimin e projekteve dhe ngritjen e fondeve rezulton të jetë emergjente. Raportohet vetëm për rreth 10% të stafit që është i trajnuar/kualifikuar për shkrim projektesh dhe ngritje fondesh. Elemente këto thelbësore për organizmat e shoqërisë civile. Gjithashtu, dobët shfaqet edhe komponenti i PR-it apo marrëdhënieve me publikun/komunitetin. Vetëm 14% e stafeve kanë kapacitete në këtë drejtim. Këtu mund të gjendet pjesërisht edhe shkaku i marrëdhënieve jo shumë të ngushta me komunitetin apo edhe imazhit thuajse tërësisht të munguar të shoqërisë civile në zonat rurale/periferike.

Rreth 60% e organizatave kanë politika të shkruara për trajtimin e stafit dhe ofrimin e mundësive të barabarta për ta. Pjesa tjetër ose raporton që nuk ka ose që nuk është në dijeni ekzistencës së tyre. Rreth 23% e pjesëmarrësve në studim raportojnë se stafet në të cilët ata bëjnë pjesë nuk janë trajnuar asnjëherë, për asnjë tematike.

Grafiku 14. Ekzistenca e politikave të shkruara për stafin?



Grafiku 15. A është trajnuar ndonjëherë stafi?




Edhe tek ato organizata të cilat kanë përvoja trajnimesh në stafet e tyre ato kanë qenë kryesisht të kufizuara tek:

- Menaxhimin e OJQ-ve (51%)
- Partneritetet privat-publik-civil (27%)
- Fondet e Bashkimit Evropian (22%)

Megjithatë, vetëbesimi dhe gatishmëria për të qenë organizata që ofrojnë trajnime nuk mungon. Mëse 43% pretendojnë se organizata që përfaqësojnë i ka kapacitet për të ofruar trajnime, 39% se i ka të pjesshme këto kapacitete dhe vetëm 16% i përgjigjen gjetjeve të mësipërme të niveleve të ulëta të trajnimit të stafi, e për pasojë thonë se nuk i kanë kapacitetet e mjaftueshme për një detyrë të tillë.


Grafiku 16. A ka organizata juaj kapacitete për të ofruar trajnime?



5.5. Pengesat, nevojat dhe vështirësitë

Në përpjekje për të identifikuar pengesat, nevojat dhe vështirësitë e hasura nga shoqëria civile në zonat rurale e periferike, pjesëmarrësve në studim iu kërkua që të përcaktonin origjinën nga buronin vështirësitë më të mëdha për këtë sektor, nga përvoja e tyre e deritanishme.


Grafiku 17. Vështirësitë më të mëdha lidhen me:



Është mëse e qartë nga grafiku i mësipërm se për të anketuarit problemet dhe vështirësitë më të mëdha lidhen me burimet dhe mbështetjen e kufizuar financiare. Dhe në të vërtetë vetëm 10% e tyre raportojnë për një rritje të


fondeve në raport me një vit më parë, 48% kanë ruajtur status-quo dhe thuajse një e treta (33%) kanë pasur rënie të burimeve financiare këtë vit krahasuar me një vit më parë.


Grafiku 18. Fondet në raport me një vit më parë



Ndër burimet kryesore financiare renditen ato që vijnë nga qeverisja qendrore dhe ajo lokale. 17% vijnë nga donatorët e huaj dhe vetëm 18% nga një total i kontributeve të biznesit, anëtarësisë, apo shërbimet e vetë organizatës. Ndarje që tregon se vetëmbështetja është ende larg. Siç shihet edhe në grafikun (20) në vijim, kjo shpërndarje nuk pritet të ndryshojë shumë në vitin e ardhshëm.


Grafiku 19. Burimi kryesor i fondeve



Grafiku 20. Pritshmëritë për buxhetin e vitit të ardhshëm

5.6. E ardhmja dhe kapacitetet për planifikim

Pak prej përfaqësuesve të shoqërisë civile të zonave rurale (36%) besojnë se shoqëria civile në këto zona i ka kapacitetet e mjaftueshme për të parashikuar ndryshimet dhe nevojat për të ardhmen e komuniteteve ku ato punojnë. Rreth 40% e tyre shprehen se këto kapacitete janë të pjesshme dhe një përqindje jo e vogël, 23% mendojnë se nuk kanë aspak kapacitete të mjaftueshme në këtë drejtim.


Grafiku 21. Kapacitetet e shoqërisë civile për parashikimin e nevojave dhe ndryshimeve

Këto gjetje e bëjnë të vështirë të besohet se me këtë imazh dhe besim që kanë vetë përfaqësuesit e shoqërisë civile në këto zona për sektorin ku ata

punojnë edhe imazhi që ka komuniteti i këtyre zonave për shoqërinë civile ashtu si edhe marrëdhënia midis saj dhe komuniteteve rurale/periferike të përmirësohen ndjeshëm në të ardhmen e afërt.


Një situatë e ngjashme rezulton edhe për qartësinë e vizionit dhe qëllimeve që ka për të ardhmen shoqëria civile në këto zona. 61% shprehen se ky vizion është pjesërisht i qartë dhe për 12% aspak i qartë.

Grafiku 22. Qartësia e vizionit të shoqërisë civile për të ardhmen




Një vizion i qartë, qëllime e objektiva të mirëpërcaktuar si dhe plane konkrete veprimi kërkojnë edhe vlerësime të vazhdueshme të kushteve të jashtme, kapaciteteve, mundësive dhe kërcënimeve. Ndonëse vlerësime të kushteve të jashtme duket se praktikohen relativisht në ritme të kënaqshme nga aktorët e shoqërisë civile në zonat rurale/periferike, një pjesë e vogël i kthejnë këto vlerësime apo edhe vlerësime të natyrave të tjera në plane konkrete.

Grafiku 23. Shpeshtësia e vlerësimit të kushteve të jashtme




Plane zhvillimi, 3 apo 5 vjeçare, kanë vetëm gjysma e organizatave të përfaqësuara në këtë studim. Me mungesë informacioni mbi përfituesit që duhet të jenë edhe mbështetësit kryesor të veprimtarie të tyre, në fakt duhet të jetë vështirë të planifikohet, duke bërë që këta aktorë të veprojnë shpesh pa plane afatmesme dhe afatgjata.

Grafiku 24. A ka organizata juaj një plan zhvillimi 3- apo 5-vjeçar?



Fakti se gati gjysma e tyre nuk kanë informacion mbi përfituesit e veprimtarisë që ata kryejnë në këto komunitet nuk shërben vetëm si një shpjegim për planifikimin e dobët të punës por edhe si një dëshmi e marrëdhënies së dobët me përfituesit dhe komunitetin në përgjithësi. Çështje e ngritur edhe nga vetë ata në pjesën cilësore të studimit.


Grafiku 25. Informacion mbi përfituesit



Po si vendosen përparësi në një kontekst ku informacione të rëndësishme mbi përfituesit apo planet afatmesme dhe afatgjata mungojnë? Grafiku i mëposhtëm rendit alternativat më të përzgjedhura prej përgjigjedhënësve. Ndonëse alternativa me e përzgjedhur është ajo e përparësive të vendosura nga vetë komuniteti, mbetet të eksplorohet më tej sesi arrijnë të identifikohen ato kur marrëdhënia me këtë të fundit lë për të dëshiruar, siç u analizua edhe më lart. Siç mund të pritej, përparësit e donatorëve qëndrojnë lart

edhe në axhendën e përparësive të shoqërisë civile në këto zona.


Grafiku 26. Faktorët përcaktues në vendosjen e përparësive për shoqërinë civile në zonat rurale/periferike




5.7. Bashkëpunimet, rrjetëzimet dhe marrëdhëniet me publikun

Përgjatë një viti, edhe pse pjesa dërmuese prej 75%, raportojnë të kenë pasur të paktën një takim me organizata të tjera, është thuajse surprizuese mungesa totale e kontakteve me organizata të tjera të shoqërisë civile në këto zona për mëse një të katërtën e tyre. Po e njëjta situatë është edhe për bashkëpunime më të ngushta si këmbime informacionesh, të dhënash apo dokumentesh që mund të lehtësojnë punën e njëri-tjetrit.

Grafiku 27. Takime me organizata të tjera gjatë vitit të fundit




Grafiku 28. A keni shkëmbyer informacione/të dhëna/dokumente me organizata të tjera?




Megjithatë në ato raste ku ka pasur shkëmbime të tilla është shkuar deri edhe në partneritete me projekte të përbashkëta me organizata të tjera (në 57% të rasteve) apo edhe partneritete dhe bashkëpunime me pushtetin vendor (59%). Një përqindje aspak për t'u neglizhuar, 40%, ka pasur një mungesë totale bashkëpunimesh; qoftë me pushtetin vendor apo me organizata të tjera të shoqërisë civile në nivele lokal dhe më gjerë.

Grafiku 29. Projekte të përbashkëta me organizata të tjera?



Grafiku 30. Bashkëpunime me pushtetin vendor




Sipas shpeshtësisë së bashkëpunimeve dhe partneriteteve të deritanishme, më të shpeshta rezultojnë të jenë ato me:

- Organizata të tjera që punojnë në zonën ku punon organizata e tyre
- Organizata ndërkombëtare apo/dhe donatorë
- Komunitetin lokal
- Institucione të pushtetit vendor

Më pak janë provuar partneritete dhe bashkëpunime me:


- Organizata të nivelit kombëtar
- Institucione të pushtetit qendror
- Median, etj.

Grafiku 31. Bashkëpunimet më të shpeshta



Bashkëpunimi i dobët me organizata të tjera në nivel kombëtar pasqyrohet edhe në pjesëmarrjen e ulët në rrjete apo organizata ombrellë. Në grafikun e mëposhtëm tregohet se vetëm gjysma e organizata pjesë e këtij studimi kanë një përvojë formale të punës në rrjet apo me një organizatë ombrellë.

Grafiku 32. A është organizata juaj anëtare formale e ndonjë grupi, rrjeti, organizate ombrellë?




Pavarësisht nga përvojat e limituara në këtë drejtim, bazuar nga sa është jetësuar deri më tani nga këto lloj bashkëpunimesh, më të frytshmet për ta kanë rezultuar bashkëpunimet dhe rrjetet me:

- OJF të tjera lokale
- OJF të huaja
- OJF të mëdha në nivel kombëtar


Pushteti vendor dhe komuniteti i biznesit mbeten partnerë të vështirë për shoqërinë civile. Sidomos marrëdhëniet me biznesin mbeten në një fazë embrional.

Grafiku 33. Bashkëpunimet më të frytshme me:




Në përmirësimin e këtyre marrëdhënieve do të kontribuonte ndjeshëm edhe një PR profesional i punës së shoqërisë civile në këto zona. Aktualisht përfaqësuesit e këtij sektori pretendojnë se bëjnë një punë relativisht të mirë në informimin e komunitetit lidhur me veprimtarinë dhe arritjet e tyre.

Grafiku 34. Sa shpesh informohen qytetarët për veprimtarinë e shoqatës që përfaqësoni?




Për informimin e qytetarëve preferohen përgjithësisht takimet në komunitet dhe publikimet e fletëpalosjeve, broshurave e buletine. Më rrallë zënë vend mes mjeteve të komunitetit mediat lokale dhe botime më të plota si raportet vjetore.

Grafiku 35. Mjetet kryesore për informimin e publikut



Puna për përmirësimin e marrëdhënieve me qytetarët duhet të ecë paralelisht edhe me atë për përmirësimin e marrëdhënieve me pushtetin vendor por edhe të aktorëve të tjerë si biznesi. Tregues i një komunikimi të dobët midis shoqërisë civile dhe këtij të fundit është edhe shkalla e dobët e informimit që kanë të anketuarit lidhur me planet e komunës apo bashkisë ku ata pretendojnë se kontribuojnë me punën e tyre. Gati 15% e tyre janë tërësisht të painformuar për këtë aspekt. Kjo e bën pothuaj të pamundur bashkërendimin e përpjekjeve dhe bashkëpunimet me ta. 50% mjaftohen me informacion të pjesshëm dhe vetëm 35% ndihen plotësisht të informuar.

Grafiku 36. A jeni të informuar mbi planet e komunës/bashkisë?



6. PËRFUNDIME

Ashtu siç ishte paralajmëruar në rishikimin literaturës mbi zhvillimin e shoqërisë civile, edhe ky studim vlerësues konfirmon faktin se shoqëria civile në zonat rurale është ende në një fazë embrionale. Zonat rurale dhe periferike janë pak atraktive për organizatat që punojnë në nivel kombëtar apo ndërkombëtar. Organizatat e shoqërisë civile me qendër në zonat rurale janë jo vetëm të pakta në numër, por edhe me një veprimtari modest dhe shpesh sporadik. Veprimtarie i ulët i shoqërisë civile dhe impakti i dobët i punës së saj në këto zona është një perceptim që ndajnë si përfaqësuesit e shoqërisë civile, ashtu edhe aktorët e tjerë në komunitet.

Pranohet gjerësisht se puna në zonat rurale/periferike ka më tepër sfida dhe vështirësi se ajo në zonat urbane, por gjithashtu identifikohen edhe avantazhe dhe veçori që e bëjnë atë interesante dhe shpërblyese. Të qenit më pranë grupeve të interesit dhe mundësia për komunikim të drejtpërdrejtë vlerësohen si një mundësi për më tepër shumë dhe impakt të qëndrueshëm në kushte normale. Po kështu ndryshimet që sjell puna e aktorëve të shoqërisë civile në këto zona të vogla behët më e ndjeshme, konkrete dhe e prekshme, cilësi që ndikojnë drejtpërdrejt edhe në përforcimin e besimit midis tre palëve shoqëri civile – komunitet – pushtet vendor.

Por, ende ka pak qartësi për sa i përket mbulimit dhe shtrirjes së misionit dhe veprimtarisë të aktorëve të shoqërisë civile në këto zona. Nevoja për të mbijetuar, pavarësisht vështirësive, i detyron një pjesë të mos jenë qartësisht të fokusuar në misionin dhe veprimtarinë e punës së tyre duke përfshirë në të një larmishmëri qëllimesh, objektivash, veprimtarish dhe përfituesish. Mbulimi gjeografik, llojet e veprimtarive dhe grupet e synuara variojnë shpesh sipas projekteve apo donacioneve të vlefshme duke krijuar jo rrallëherë një mozaik që mund të cenojë cilësinë dhe rezultatet, e për pasojë të cenojë besimin e grupeve të interesit apo komuniteti në përgjithësi.

Shoqëria civile në zonat rurale mbetet e kufizuar në shtrirje dhe veprimtari si pasojë e shumë vështirësive dhe pengesave që lidhen me kufizime financiare, mentalitete rixhide, rezistencë dhe mungesë tradite në

këto komunitete, mungesë bashkëpunimi nga ana e pushteti vendor etj. Megjithatë, veç trajtimit të këtyre sfidave, shoqërisë civile në këto zona i duhet të trajtojë edhe problematika që lidhen me imazhin që ajo gëzon në komunitet dhe shkallën e ndërgjegjësimit e njohurive që ajo vetë ka për rolin që duhet të luajë si dhe kapacitetet që duhet të ketë për të qenë në lartësinë e rolit dhe përgjegjësisë e sektorit.

Deri më sot imazhin e shoqërisë civile në zonat rurale e ka përmirësuar veçanërisht puna që është bërë për trajtimin e çështjeve që lidhen me advokacinë dhe lobimin për grupe të caktuara interesi apo për zonën në tërësi, për të drejtat e grave dhe fëmijëve (përfshi kategori të veçanta të tyre si p.sh gratë e dhunuara); ruajtjen dhe promovimin e kulturës, traditës dhe zakoneve të zonës; mbrojtjen e mjedisit dhe promovimi i turizmit (kulturor dhe mjedisor); apo për promovimin e grupeve të ndryshme profesionale (p.sh fermerëve, artizanëve, gazetarëve lokalë etj.). Ndërkohë, kërkohet që në të ardhmen shoqëria civile në këto zona të mund të kthejë sytë edhe drejt disa çështjeve që komuniteti i konsideron të rëndësishme, por pak të prekura si drejt nevojës për vende të reja pune, projekte për zhvillimin rural e bujqësor, zhvillimin e infrastrukturës së zonës, ndërgjegjësimin e komunitetit, inkurajimin e vullnetarizmit dhe punës në komunitet, pjesëmarrjen më të madhe të grave në jetën komunitare, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteve apo grupeve me nevoja të veçanta.

Në përpjekjet e tyre për të sjellë ndryshim, aktorët e shoqërisë civile në zonat rurale ndihen jo vetëm të pafuqishëm, por jo rrallë edhe të vetmuar pasi bashkëpunimet me pushtetin vendor, median e veçanërisht me aktore të të njëjtit sektor janë të kufizuara. Në asistencën që mund të ofrohet për ngritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile, do të duhet të trajtohen jo vetëm nevojat imediate që identifikohen prej tyre si trajnime e kualifikime për shkrim projektsh dhe ngritje e menaxhim fondesh, por edhe përmirësimin e marrëdhënieve me publikun, median, pushtetin vendor dhe biznesin, si dhe ndërtimin e partneriteteve dhe rrjeteve brenda shoqërisë civile dhe më gjerë. Në këtë kuadër, detyra, përgjegjësi dhe oportunitete dalin si për vetë shoqërinë civile ashtu edhe për pushtetin vendor, biznesin dhe komunitetin në tërësi dhe aktorë të tjerë.

7. REKOMANDIME

Seksioni i fundit i raportit të vlerësimit fokusohet tek identifikimi i implikimeve të gjetjeve kryesore të këtij studimi si dhe gjenerimi i alternativave relevante për aksion nga vetë aktorët në fokus të këtij vlerësimi.

- Studimi demonstroi se ndonjë konstatim i përgjithshëm për shoqërinë civile në zonat rurale është i tillë ku asnjë prej fushave nuk mund të thuhet se mbulohet në nivele të kënaqshme, një pjesë prej tyre mbeten më pas se të tjerat. Në këtë kontekst, një prej rekomandimeve kryesore do t'u drejtohej vetë aktorëve të shoqërisë civile për të qenë më alert dhe për të orientuar veprimtaritë e tyre edhe ndaj çështjeve të tilla si:
 - Veprimtari me synim inkurajimin dhe lehtësimin e punësimit në zonat rurale, zhvillimin rural dhe përfshirjen e tyre në fokusin e programeve të BE
 - Ndërgjegjësimin e komunitetit, inkurajimin e vullnetarizmit dhe punës në komunitet,
 - Pjesëmarrjen më të madhe të grave në jetën komunitare, politikëbërje etj.
 - Rritjen e bashkëpunimi ndër-institucional;
 - Mbrojtjen e të drejtave të minoritetit;
 - Çështjet sociale në përgjithësi dhe njerëzit me aftësi të kufizuara dhe shërbimi shëndetësor e arsimor në veçanti.
- Ritmet e ulëta të zhvillimit të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike të vendit përcaktohen ndjeshëm nga mundësitë e bashkëpunimit dhe konkretizimi i tyre, midis aktorëve të shoqërisë civile, institucioneve të pushtetit vendor dhe sektorit të biznesit lokal. Në këtë kuadër, një prioritet i kësaj çështjeje në axhendat e shoqërisë civile dhe pushtetit vendor duhet të përbëjë një rekomandim thelbësor për të ardhmen.
- Për një shoqëri civile të dukshme dhe aktive në zonat rurale dhe periferike, jo vetëm partneriteti me pushtetin vendor dhe biznesin, por edhe bashkëpunimi dhe partneriteti brenda shoqërisë civile rezultojnë të jetë një domosdoshmëri. Bashkërendimi i përpjekjeve në fusha të ngjashme veprimi, bashkëpunimet e partneritetit si dhe rrjetëzimet e

aktorëve të shoqërisë civile në zonat rurale duhet të inkurajohen dhe lehtësohen për t'u stabilizuar dhe bërë funksionale.

- Përforcimi i rolit të shoqërisë civile në zonat rurale e periferike duhet të jetë rezultat i ngritjes së kapaciteteve të brendshme që ajo ka. Rekomandimi për ngritje dhe përforcim kapacitetesh vlen si për ato humane ashtu edhe për ato infrastrukture; konsolidimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore sidomos në raport me shkrimin e projekteve dhe ngritjen e fondeve janë veçanërisht të rëndësishme për qëndrueshmërinë dhe vetmbështetjen e aktorëve të shoqërisë civile në këto zona.
- Së fundi, por jo për nga rëndësia, shoqëria civile në zonat rurale dhe periferike duhet të ndihet dhe të veprojë si pjesë e këtyre zonave. Veprimtaria e saj duhet të jetë e lidhur ngushtë me komunitetin, të pasqyrojë interesat e tyre, trajtojë problematikat e tyre si dhe t'ia tregojë punën dhe arritjet e saj në një mënyrë sa më transparente e të vazhdueshme. Qartësimi i profilit të aktorëve të këtij sektori, ngritja e kapaciteteve për marrëdhëniet me publikun, si dhe përfshirja aktive e grupeve të interesit do të ishin disa prej përqasjeve për t'u ndjekur në këtë kuadër.

8. PARTNERË PËR NJË SHOQËRI CIVILE AKTIVE NË ZONAT RURALE/PERIFERIKE: NJË PLATFORMË ALTERNATIVASH

Përfaqësues të Qeverisë shqiptare, Kombeve të Bashkuara, Delegacionit të BE, institucioneve me fokus zhvillimin e grupeve dhe zonave të marginalizuara, shoqërisë civile dhe medias u përfshinë në një proces konsultimi në kuadër të Seminarit Kombëtar “Fuqizimi i shoqërisë civile në zonat rurale & periferike” (Tiranë, 1 Mars 2012) mbi një platformë alternativash për nxitjen e sektorit civil në zonat rurale / periferike në Shqipëri.

Bazuar në gjetjet paraprake të studimit “Shoqëria civile në zonat rurale dhe periferike në Shqipëri” si edhe përvojën dhe këndvështrimet e aktorëve kyç me fokus zhvillimin e sektorit civil në zonat periferike në vend, pjesëmarrësit në Seminar identifikuan një kuadër të gjerë masash për një shoqëri civile aktive në këto zona. Kuadri i masave dhe alternativave zhvillimore sugjerohet të formësojë tre dimensione kryesore të ndërhyrjes për fuqizimin e sektorit civil në zonat rurale dhe periferike, si vijon:

1. Trajtimi i sfidave dhe nevojave imediate
2. Inkurajimi i partneriteteve, rrjetëzimeve dhe përfshirjen e qytetarëve
3. Vazhdimësia dhe ardhmja e shoqërisë civile në zonat rurale/periferike

Sugjerimet dhe rekomandimet e mbi 170 pjesëmarrësve në Seminarin Kombëtar detajojnë dhe plotësojnë kuadrin e rekomandimeve të këtij studimi duke targetuar jo vetëm aktorët e shoqërisë civile por para së gjithash edhe aktorët shtetërorë në nivel kombëtar dhe vendor si edhe komunitetin e donatorëve.

8.1. Trajtimi i sfidave dhe nevojave urgjente

- Pavarësisht pasivitetit të komunitetit në zonat rurale dhe periferike për t’u bërë pjesë e aksionit të shoqërisë civile, nismat e deritanishme (p.sh emergjencat natyrore) nënvizojnë potencialin dhe gatishmërinë e

komunitetit për bashkëpunim komunitar në zgjidhjen e problemeve, çka sugjeron nevojën për nxitjen e këtyre nismave.

- Një tjetër problematikë e cila mund të trajtohet gjithashtu më së miri prej organizatave komunitare në bashkëpunim me strukturat vendore është gjithashtu mundësia për bashkë-menaxhimin nga OShC vendore dhe nga institucionet publike në bashkëpunim me njëri-tjetrin të shkollave në zonat rurale apo shërbimeve të tjera publike të ofruara nga pushteti vendor.
- Koncepti i vullnetarizmit dhe angazhimit komunitar ka nevojë për promovim të mëtejshëm sidomos në zonat rurale dhe ato periferike ku potenciali për nxitjen e tij është më i lartë. Një strukturë e rëndësishme që duhet mbështetur për sa i përket organizimit të komuniteteve janë dhe Grupet Lokale të Veprimit. Gjithashtu duhen mbështetur edhe përpjekjet për nisma të rrjetëzimit ndërmjet OShCR-ve.
- Duhet synuar rritja e kapaciteteve të OShCR-ve por jo vetëm. Gjithashtu nevojitet edhe mbështetja për nisma që synojnë rritjen e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor dhe OShCR-ve. Nxitja e një programi grantesh të vogla kërkesat e të cilit përputhen me stadin aktual të kapaciteteve të OShCR do të ndihmonte për revitalizimin e sektorit civil në këto zona.
- Përmirësimi i imazhit të sektorit civil dhe OShC-ve në këto zona duhet të të pasqyrohet para së gjithash në aksionin e vetë aktorëve të sektorit, duke nxitur dhe mbështetur praktikën e mirë-menaxhimit, gjithëpërfshirjen dhe parimet e mirë-qeverisjes si përgjegjshmëria, transparenca etj. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar gjithashtu edhe OShCR-ve me bazë anëtarësie.
- Komuniteti i donatorëve duhet të diversifikojë spektrin e mbështetjes dhe të lehtësojnë proceduarat për zbatimet nga zonat rurale / periferike duke ofruar gjithashtu edhe asistencë për ata sektorë dhe aktorë të cilët nuk disponojnë nivelin e duhur të kapaciteteve për zbatime.
- Në funksion të një mjedisi vendor në zonat rurale e periferike sa më ndihmues për sektorin civil, roli i pushtetit vendor mbetet thelbësor. Partneriteti me sektorin civil ka hapësira të mëtejshme për tu zhvilluar veçanërisht në zonat periferike edhe nëpërmjet financimeve modeste për shërbime që i ofrohen komunitetit vendor.

8.2. Inkurajimi i partneriteteve, rrjetëzimeve dhe përfshirjen e qytetarëve

- Nevojitet bashkërendimi i përpjekjeve ndërmjet qeverisë, OShC/OShCR, donatorëve ndërkombëtarë dhe sektorit privat. Shkëmbimi i përvojave dhe këndvështrimeve për trajtimin e barrierave ndaj rrjetëzimit shfaqet si një pikënisje efikase për thellimin e ndikimit në këtë kontekst.
- Kërkohet shkëmbim i aftësive ndërmjet OShC urbane të cilat kanë arritur një stad zhvillimi më të konsoliduar dhe OShCR-ve si dhe rritja e rrjetëzimeve lokale dhe kombëtare ndërmjet OShC-ve si potencial për zhvillimin e OShCR-ve. Ky proces duhet të përfshijë edhe projekt-idetë ndërmjet OShC-ve dhe OShCR-ve si dhe një bashkërendim i veprimtarisë së tyre për të evituar mbivendosjet. Një alternativë e mundshme në këtë drejtim mund të jenë planet vjetore për OShC-të në nivel lokal.
- Komunikimi i vazhdueshëm dhe transparenca janë pikënisja për një partneritet të qëndrueshëm me komunitetin dhe përfshirjen qytetare në aksionet e shoqërisë civile.
- Pushteti vendor mund të ndihmojë në rritjen dhe ruajtjen e kapaciteteve të OShCR-ve pasi ato janë përçues të problematikës së komuniteteve ku veprojnë dhe njohëse shumë të mira të realitetit lokal.
- Biznesi duhet të shqyrtojë më gjerësisht mundësitë për financim si shprehje e vëmendjes së tij për situata që shqetësojnë shoqërinë dhe të rrisë bashkëpunimin me aktorët lokalë. Në këtë kontekst, është thelbësore pasurimi i kuadrit të incentivave nga ana e aktorëve shtetërorë.

8.3. Vazhdimësia dhe ardhmja e shoqërisë civile në zonat rurale/ periferike

- Kërkohet me domdososhmëri një de-volvim (de-centralizim) pushteti si një mjet për shtrirjen e qeverisjes tek qytetarët.
- Pushteti vendor duhet të angazhojë kapitalin human të këtyre shoqatave për të mos e humbur atë. Nisma të tilla si krijimi i Kooperativave Private, dhënia me koncesion e monumenteve të kulturës, si dhe një sërë nismash të tjera duhet të nxiten për rritjen e pjesëmarrjes qytetare në zgjidhjen e problemeve që iu takojnë komuniteteve.
- Qeverisja qendrore edhe ajo vendore duhet të luajë një rol më aktiv në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimarrje dhe në zgjidhjen e problemeve për Shoqërinë Civile në përgjithësi dhe për Shoqërinë Civile në Zonat Rurale në veçanti. Alternativat e mundshme do të mund të fillonin me zgjidhjen e përfaqësuesve të lagjes, kryepleqve

dhe strukturave komunale dhe atyre bashkiake si edhe shfrytëzimin e këtyre hallkave në kuadër të partneritetit me shoqërinë civile, si edhe në hartimin e strategjive e planeve zhvillimore.

- Përfshirja e gjerë qytetare dhe e sektorit civil duhet konsideruar edhe në kontekstin e projekteve dhe planeve në kuadër të asistencës së BE dhe procesit të anëtarësimit në mënyrë që të pasqyrojnë sa më mirë nevojat dhe përparësit e komuniteteve vendorë. Shfrytëzimi i mundësive që ofrohen nga procesi i integritetit të vendit i cili kërkon konsultimet me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për të gjithë sektorët parësorë të vendit.
- Nevojitet stimulimi i ideve dhe përparësive që vendosen nga komuniteti dhe në këtë kontekst qeverisja në të gjithë nivelet si edhe shoqëria civile duhet të asistojnë komunitetin e donatorëve për priorizimin lokal të agjendës së tyre.
- Strategjitë e donatorëve për vendin duhen bazuar në kontekstin lokal dhe jo atë global. Donatorët mund të ndihmojnë duke dhënë një feedback më të zgjeruar për projekt propozimet e OShC-ve / OSHCR-ve të cilat nuk janë fituese.
- Vërehet një raport i pa ekuilibruar ndërmjet rrolit të qeverisjes vendore dhe shoqërisë civile. Krijimi i nismave të tilla si Fondi i Partneritetit të cilat të orientohen nga pushteti vendor drejt OShCR-ve i shërbejnë zhvillimit.
- Regjistrimi i OShC-ve dhe sidomos i atyre lokale/rurale/periferike do të ndihmonte për zhvillimin e përvojave dhe rritjen e shkëmbimeve e bashkëpunimeve. Aktualisht ekzistojnë dy regjistra OShC-sh njëri i Partners Albania dhe tjetri i UNDP. Një hap i mirë fillestar do të ishte pasurimi i këtyre regjistrave.

9. BURIMET

• Burimet kryesore

Biberaj, Elez. Shqipëria në tranzicion. Rruga e vështirë drejt demokracisë. Tiranë: Botimet Ora, 2001.

Brkic, Srecko. Zutinic, Durdica. & Tratnik, Miroslav. "Articulation of the Farmer's interest through Protests," *Sociology and Space*, vol.42, No.314, {march 2009}. http://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=54757&lang=en. Accessed in August 2011

Cicea, Claudio. Subic, Jonel & Ivanovic, Sanjin, "Economic effectiveness of activities of vegetable growers' associations in Serbia." *Economia Seria Management*, Vol.1. Nr.1. {2009}. <http://www.management.ase.ro/reveconomia/2009-1/2.pdf>. Accessed in August 2011.

Civicus, Global Survey for Country Reports. Vol. 1 Country Profile. USA: Kumarian Press INC, 2007.

Clayer, Natalie, Në fillimet e nacionalizmit Shqiptar. Lindja e një Kombi me shumicë myslymane në Evropë Tiranë: Botimet Përpjekja, 2009.

Euclid & Human Development Promotion Center. Third Sector Development in Albania. Challenges and opportunities. Human Development Promotion Center, Tirana: 2009. <http://www.euclidnetwork.eu/data/files/albania1.pdf>. Accessed in August 2011.

Europartners Development and AYNEY, Increasing the capacities of Albanian NGOs towards future sustainability. 2009

Hann, Christine, et.al. *Civil Society: Challenging Western Models*. London: Routledge, 1996.

Institute for Democracy and Mediation, Civil society index for Albania. In search of citizens and impact. Tiranë: 2010.

Institute for Democracy and Mediation, An Action Agenda for Civil Society. The path to increased impact and Civic engagement. Policy Brief, Tiranë: July 2010

International Center for Democratic transition, Enhancing Sustainable

- Rural Development in the SAP Countries by Introducing the LEADER Experience. http://www.icdt.hu/admin/download/a178ICDT_LEADER_Final_Report_web.pdf. Accessed in August 2011.
- Lampietti, Julian, Lugg, David, Van der Cellen, Philip, Branczik, Amelia "The changing face of rural space. Agricultural and rural development in Western Balkans.", the World Bank: Washinton DC:2009 http://www.ju.dk/uk/college_profile/projects/Western_%20Balkans.pdf. Accessed in October 2011
- Mercy Corps work in Kosova. "Not small Potatoes, 9 August 2010." <http://www.mercycorps.org.uk/countries/kosovo/21531>. Accessed in September 2011
- Oxfam work in Albania: http://policy-practice.oxfam.org.uk/publications/search?i=1;q=*;q1=publications;q2=agriculture;x1=page_type;x2=subject_area. Accessed in August 2011
- Rural Poverty Portal, "Rural Poverty in Albania." <http://www.ruralpovertyportal.org/web/guest/country/home/tags/albania>. Accessed in October 2011
- Sterland, Bill. & Rizova, Gallna, "Civil Society organizations' capacities in the Western Balkans and Turkey. A comparative study of the eight country's needs assessment." 2010. <http://www.tacso.org/documents/reports/?id=2980>. Accessed in August 2011.
- Swedish International Development Agency (SIDA), "Macedonian farmers find a voice." <http://www.sida.se/English/Countries-and-regions/Europe/Macedonia-/Programmes-and-projects1/Programmes-and-Projects/>. Accessed in August 2011
- Thëngjilli, Petrika, Shqiptarët midis lindjes dhe Perëndimit., Maluka, Tiranë: 2004
- TACSO, "Albania needs assessment report", 29 January 2010, <http://www.tacso.org/doc/doc0054.pdf>. Accessed in September 2011
- UNDP Albania website, "Kukës Region Cross Border Cooperation Programme (KRCBC) September 2009 – May 2011.", <http://www.undp.org.al/index.php?page=projects/project&id=186>. Accessed in October 2011
- USAID, "Kosovo biodiversity Assessment.", 2003 <http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Kosovo-BiodiversityAssessment.pdf>. Accessed in September 2011.
- USAID, "Kosovo Cluster and Business support project. Building Alliances Between Kosovo Association of Milk Producers and Serbian Farmers.",

2005 http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADD888.pdf. Accessed in August 2011.

USAID, "Europe and Euroasia, Cultivating a symbol for peace: Revitalizing Montenegro's Olive industry." http://www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/press/success/2006-02-20.html. Accessed in August 2011

USAID, "NGO sustainability index for Albania." 2009: http://www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/2009/albania.pdf. Accessed in August 2011

Website of Partners for Development: Bosnia Herzegovina. <http://www.pfd.org/where-we-work/bosnia-a-herzegovina>. Accessed in August 2011

World Bank Tirana Office, "The World Bank Financing to Albania." 2010:http://issuu.com/worldbankalbania/docs/portofoglio_2010_ok?mode=a_p. Accessed in September 2011.

Burime të tjera

- Albanian Rural Network (ARN). <http://www.albanianrural.net/index.php>. Accessed in August 2011
- Farmers Federation of Kukës website. [On Line]: <http://fedfarmqk.org/>. Accessed in August 2011.
- EU-Balkans FabNet: <http://www.balkan-fabnet.eu/main.php>. Accessed in August 2011.
- Guri, Gentian, "The role of cooperatives in Sustaining Development and Fostering Social Responsibility." ICA Research Conference, Trento: Italy, 2008: <http://www.acdivocacoopex.org/>. Accessed in August 2011.
- Këshilli i Agrobiznesit shqiptar (KASh), <http://www.kash.org.al/sq/index.php>. Accessed in August 2011.
- Ministry of Agriculture, Food and Consumer Protection, <http://www.mbumk.gov.al>. Accessed in August 2011.
- Ministry of Environment, Forestry and Water Management, <http://www.moe.gov.al>. Accessed in August 2011
- Rural Associations Support Programme, <http://www.rasp.org.al/>. Accessed in August 2011
- Shoqata e Bujqësisë Organike, http://organic.org.al/SHQIP/index_al.html. Accessed in August 2011

10. ANEKSE

10.1. Intervista gjysmë e strukturuar me informatorë kyç.

Vlerësim i shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike

Intervista cilësore me aktorë të shoqërisë civile që operojnë në zonat rurale e periferike

Struktura e çështjeve të intervistës

ÇËSHTJA	PYETJE SPECIFIKE	SHËNIME
Përfshirja në zonat rurale dhe periferike (kundrejt zonave urbane)	1. Shkurtimisht, historiku i përfshirjes së OJQ-së suaj në zonat rurale e periferike	
	2. Cilat ishin arsytet që ju bënë të nisni këtë veprimtari? Cilat ishin çështjet kryesore tek të cilat u fokusuat? Perse?	
	3. Si do ta krahasonit punën tuaj në zonat rurale / periferike me veprimtarinë e OJF-ve në zonat e mëdha urbane? Cilat janë ndryshimet dhe detajet që bëjnë diferencën – përfshirë interesimin, sfidat dhe vështirësitë?	
Mbulimi	1. Cili është mbulimi gjeografik i veprimtarisë të OJF-së suaj?	
	2. Cilat janë llojet e veprimtarive që ndërmerrni e zbatoni?	
	3. Cilët janë përfituesit kryesore dhe grupet e synuara me të cilat punoni dhe ndërtoni partneritete?	

ÇËSHTJA	PYETJE SPECIFIKE	SHËNIME
Kapacitetet dhe shkalla e njohurive	1. Çfarë lloj burimesh dhe mbështetje ka ne dispozicion për OJF-te që punojnë ne zonat rurale dhe periferike?	
	2. Stafit: Si e gjykoni mjaftueshmërinë e stafit nga pikëpamja e cilësisë dhe e numrit? (përfshirë arsimi, kualifikimet, trajnimet, etj) Cilat janë nevojat? a. Ndërgjegjësimi: A janë OJF-të në zonat rurale e periferike të ndërgjegjshme për rolin që luajnë apo duhet të luajnë? Po komunitetet vendore a janë të ndërgjegjshme për këtë rol? Përse?	
Përvoja e deritanishme	1. Cilat janë arritjet kryesore të organizatës suaj ose të rrjeteve ku ju bëni pjesë në zonat rurale / periferike?	
	2. Shkurtimisht përshkruani një përvojë të suksesshme	
	3. Cilat janë vështirësitë kryesore me të cilat hasen OJF-te në zonat rurale e periferike?	
Nevojat dhe sfidat (sidomos ato që kanë të bëjnë me kontekstin e zonave rurale e periferike)	1. Cilat janë anët e forta dhe të dobëta të organizatës suaj?	
	2. Cilat janë nevojat kryesore?	
	3. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballeni?	
	4. Çfarë mundësish zhvillimi ka për OJF-të dhe shoqërinë civile në zonat rurale e periferike? (përfshirë financimet)?	
Rrjetëzimi dhe bashkëpunimet	1. A ka nisma rrjetëzimi midis OJF-ve që punojnë në zonat rurale / periferike? Jepni shembuj! Nëse po, në cilat fusha operojnë dhe çfarë aktoresh përfshijnë? Si e gjykoni punën e këtyre rrjeteve?	
	2. Si janë marrëdhëniet e bashkëpunimit midis OJF-ve në zonat rurale / periferike dhe pushtetit vendor në këto zona?	

ÇËSHTJA	PYETJE SPECIFIKE	SHËNIME
Vazhdimësia (e ardhmja e shoqërisë civile në zonat rurale/periferike)	1. Si e imagjinoni të ardhmen e shoqërisë civile në zonat rurale e periferike? Si e shihni organizatën tuaj pas 5 vitesh?	
	1. A mendoni se ka një mjedis nxitës për fuqizimin dhe zgjerimin e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike? Nëse po, në cilat zona mendoni sa ka me shume shanse për një gjë të tillë? Sa kohe do të duhet për ta arritur këtë?	
	3. Në cilat fusha dhe sektorë mendoni se ka me shume rëndësi përfshirja e OJF-ve në zonat rurale dhe periferike? Në cilat fusha e sektorë ka më shumë shanse fuqizimi i veprimtarisë dhe ndikimit të OJF-ve në zonat rurale e periferike? Perse?	
	1. Përveç financimit, tek cilët faktorë të tjerë do të mbështeteshit për vazhdimësinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të organizatës suaj (mbështetje nga komunitetet, pushteti vendor etj.)?	
Çështje të tjera me rëndësi	- Në këtë seksion, nxiteni bashkëbiseduesin tuaj të ndajë dhe të japë informacion në lidhje me çështje të rëndësishme mbi shoqërinë civile në zonat periferike dhe rurale.	
	...	
	...	

Të dhënat e të intervistuarit:

1. Emri i organizatës / institucionit
2. Emri dhe pozicioni i personit të intervistuar
3. Numër kontakti i organizatës/institucionit dhe i personit (celular, telefon fiks dhe adresë email-i, përfshirë website i organizatës, nëse ka).

10.2. Sondazhi

Pyetësor për organizatat e shoqërisë civile në zonat rurale/periferike 2011

Kujt i drejtohet ky pyetësor?

Ky pyetësor është hartuar për dhe i drejtohet të gjitha llojeve të organizatave të shoqërisë civile të vendosura dhe/ose që punojnë në zonat rurale të qarqeve Lezhë, Berat, Elbasan dhe Gjirokastrë si dhe bashkëpunëtorëve të tyre në pushtetin vendor dhe media. Nëse jeni përfaqësues i një institucioni të tillë, atëherë ju mund të përfshihenit në këtë studim si dhe mund të ftoni kolegët tuaj për t'u bërë pjesë e këtij studimi përmes plotësimit të këtij pyetësori.

Ftesë për bashkëpunim

Të nderuar kolegë,

Ekipi kërkimor i ngritur nga IDM në kuadër të projektit “Fuqizimi i shoqërisë civile në zonat rurale për të promovuar zhvillimin dhe qeverisjen e mirë”, mbështetur nga UNDP Shqipëri, ka kënaqësinë t’iu ftojë të merrni pjesë në një studim i cili synon vlerësimin e nevojave, problematikave dhe mundësive të organizatave të shoqërisë civile të cilat janë të vendosura dhe/ose punojnë në zonat rurale të qarqeve Lezhë, Berat, Elbasan dhe Gjirokastrë. Së dyti, studimi synon të përvijojë disa rekomandime lidhur me hapat prioritarë që duhet të ndërmerren për të inkurajuar dhe lehtësuar punën dhe zhvillimin e shoqërisë civile në zonat rurale e periferike në Shqipëri.

Përgjigjet tuaja janë një kontribut i pazëvendësueshëm në suksesin e këtij projekti. IDM garanton anonimin e kësaj interviste.

Ju falënderojmë!

SEKSIONI I

Informacion i Përgjithshëm

- 1.1 Emri mbiemri: _____
- 1.2 Nr. telefoni: _____
- 1.3 E-mail: _____
- 1.4 Qarku/Bashkia/Komuna: _____
- 1.5 Institucioni që përfaqësoni _____
- 1.6 Pozicioni: _____

Drejtues i organizatës/institucionit	1 ☐
Staf i organizatës/institucionit	2 ☐
Tjetër (specifiko) _____	3 ☐

1.7 Ku ndodhen zyrat e organizatës suaj?

Fshat	1 ☐
Qytezë	2 ☐
Qytet i madh (qendër qarku)	3 ☐

1.8 Ju jeni pjesë e një:

Organizate joqeveritare	1 ☐
Institucioni të pushtetit vendor	2 ☐
Media	3 ☐
Tjetër _____	4 ☐

Cili ka qenë motivi kryesor për themelimin e organizatës suaj? (Mund të zgjidhni më tepër se një alternativë.)

Zgjidhja e një problem specifik	1 ☐
Nxitja dhe mbështetja e zhvillimit në zonën ku vepron	2 ☐
Promovimi i interesave publike	3 ☐
Promovimi i interesave private	4 ☐
Advokaci (një proces politik drejtuar nga një individ apo një grup që synon influencimin e politikave publike dhe vendimmarrjen)	5 ☐
Ofrimi i shërbimeve sociale	6 ☐
Mbështetja e grupeve të caktuara në komunitet	7 ☐
Ofrim ekspertize	8 ☐

Politikë-bërje	9 ☐
Nevoja financiare (një lloj punësimi)	10 ☐
Tjetër _____	11 ☐

1.10 Sa aktive do ta konsideronit shoqërinë civile në zonën tuaj në një shkallë nga 1 (shumë aktive) në 5 (aspak aktive)?

1 2 3 4 5

1.11 Si do ta vlerësonit impaktin e punës së shoqërisë civile në komunitetin ku punoni në një shkallë nga 1 (shumë aktive) në 5 (aspak aktive)?

1 2 3 4 5

1.12 Sipas mendimit tuaj, 3 fushat kryesore që mbulohen më mirë nga veprimtarie i shoqërisë civile në zonën tuaj janë: (Rendit tre më kryesoret sipas rëndësisë).

1.....
2.....
3.....

1.13 Sipas mendimit tuaj, 3 fushat që mbulohen më pak nga veprimtarie i shoqërisë civile në zonën tuaj janë:

1.....
2.....
3.....

1.14 A ka organizata/institucioni juaj akses në:

	Po 1 ☐	Jo 2 ☐
a. Telefon		
b. Faks		
c. Kompjuter		
d. Internet		

SEKSIONI II

Shoqëria civile dhe zonat/mjedisi rural/periferik

2.1. Si do ta vlerësonit mjedisin rural/periferik në raport me shoqërinë civile dhe veprimtarinë e saj në një shkallë nga 1-5 ku 1 është shumë

mbështetës/bashkëpunues dhe 5 totalisht pengues?

1 2 3 4 5

2.2. Sipas jush, është më e lehtë të themelosh një organizatë në:

Qytet	1 ☐
Fshat	2 ☐
Nuk ka ndonjë ndryshim	3 ☐

2.3 Komuniteti/grupet e interesit janë më aktive dhe përfshihen më shumë e më lehtë në veprimtaritë e shoqërisë civile në:

Qytet	1 ☐
Fshat	2 ☐
Nuk ka ndonjë ndryshim	3 ☐

2.4 Sipas mendimit tuaj, a i përgjigjet niveli aktual i zhvillimit të shoqërisë civile në zonat rurale/periferike, vetë nevojave dhe problematikave të këtyre zonave?

Plotësisht	1 ☐
Pjesërisht	2 ☐
Aspak	3 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

2.5 A përfshihet komuniteti i zonave rurale në veprimtaritë e shoqërisë civile për vendosjen e përparësive të axhendës së tyre (organizatave të shoqërisë civile)?

Plotësisht	1 ☐
Pjesërisht	2 ☐
Aspak	3 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

2.6 Në zonën ku ju punoni (qarkun tuaj), a janë minoritetet dhe çështjet e tyre të përfshira dhe përfaqësuara nga shoqëria civile?

Plotësisht	1 ☐
Pjesërisht	2 ☐
Aspak	3 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

2.7 Në zonën ku ju punoni, a janë gratë dhe çështjet e tyre të përfshira dhe përfaqësuara nga shoqëria civile?

Plotësisht	1 ☐
Pjesërisht	2 ☐
Aspak	3 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

2.8 Sa shpesh bëni vlerësime dhe analiza të kushteve të jashtme ku vepron organizata juaj?

Më pak se 1 herë në vit	1 ☐
1 herë në vit	2 ☐
2 herë në vit	3 ☐
4 herë në vit	4 ☐
Çdo muaj	5 ☐
Kurrë	6 ☐

Shënim: Seksionet në vijim (Seksioni III, IV, dhe V) janë vetëm për përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

SEKSIONI III

Kapacitetet dhe çështjet organizative

3.1 Cilat janë burimet njerëzore në organizatën tuaj??

Të punësuar me kohë të plotë	_____ %
Të punësuar me kohë të pjesshme)	_____ %
Vullnetarë	_____ %
Gra	_____ %
Burra	_____ %

3.2 Sa shpesh bëni vlerësime dhe analiza të kushteve të jashtme ku vepron organizata juaj?

Me arsim të lartë	_____ %
Që mund të punojë në gjuhën angleze	_____ %
Që është e trajnuar për shkrim projektsh	_____ %

Që është e trajnuar për ngritje fondesh	_____ %
Që është e trajnuar për marrëdhëniet me përfituesit dhe komunitetin në përgjithësi	_____ %

3.3 A ka organizata juaj politika të shkruara për trajtimin e stafit dhe ofrimin e mundësive të barabarta për punonjësit?

Po	1 ☐
Jo	2 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

3.4 A është trajnuar ndonjëherë stafi i organizatës suaj?

Po	1 ☐
Jo (Kalo tek pyetja 3.6)	2 ☐
Nuk e di / Refuzim (Kalo tek pyetja 3.6)	99 ☐

3.5 A është trajnuar ndonjë prej anëtarëve të stafit tuaj lidhur me:

	PO 1 ☐	JO 2 ☐	Nuk e di / Refuzim 99 ☐
Menaxhimin e OJQ-ve			
Partneritetet privat-publik			
Fondet e Bashkimit Evropian			

3.6 A ka organizata juaj kapacitete të nevojshme për të organizuar trajnime?

Po, ka kapacitete të mjaftueshme	1 ☐
Po, ka kapacitete të pjesshme	2 ☐
Nuk ka kapacitete	3 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

3.7 Sipas mendimit tuaj, pengesat më të mëdha në realizimin e veprimtarive të shoqërisë civile në zonën tuaj lidhen me?

1. Mungesa në burime njerëzore (në ekspertizë)	1 ☐
2. Mungesa në burime financiare	2 ☐
3. Mungesa infrastrukturore (zyra, pajisje etj)	3 ☐
4. Mungesa e bashkëpunimit nga institucionet publike	4 ☐
5. Tjetër (specifiko)_____	5 ☐

3.8 A besoni se shoqëria civile në zonën tuaj ka kapacitetin për të parashikuar ndryshimet dhe nevojat për të ardhmen e komunitetit të zonës?

Kapacitet janë të mjaftueshme	1 ☐
Kapacitet janë deri diku të mjaftueshme	2 ☐
Kapacitet janë të pamjaftueshme	3 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

3.9 A besoni se shoqëria civile në zonën tuaj ka vizion të qartë të qëllimeve/objektivave që duhet t'i arrijë për 5-10 vitet e ardhshme?

Plotësisht	1 ☐
Pjesërisht	2 ☐
Aspak	3 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

3.10 A keni informacion për numrin e qytetarëve që përdorin shërbimet apo përfitojnë nga veprimtaritë e shoqërisë civile në komunitetin tuaj?

Po, të hollësishëm	1 ☐
Po, por jo të plotë	2 ☐
Nuk kam informacion	3 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

SEKSIONI IV

Nevojat financiare dhe menaxheriale

4.1 Bazuar në vitin e kaluar financiar rendisni sipas rëndësisë (ku 1 është më i rëndësishmi) burimet e mëposhtme financiare për buxhetin e organizatës suaj?

Qeverisje qendrore	1 ☐
Qeverisje lokale	2 ☐
Donator të huaj	3 ☐
Donacione individuale të qytetarëve	4 ☐
Donacione nga biznesi	5 ☐
Kuotizacionet e anëtarëve	6 ☐
Të ardhura nga shërbimet e organizatës	7 ☐

Tjetër _____	8 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

4.2 Krahasuar me një vit më parë fondet e organizatës suaj:

U rritën	1 ☐
U ulën	2 ☐
Nuk ndryshuan	3 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

4.3 Nga mendoni se duhet të gjeneroni shumicën e fondeve në të ardhmen? (Rendisni sipas rëndësisë duke nisur nga 1 = burimi kryesor.)

Qeverisje qendrore	1 ☐
Qeverisje lokale	2 ☐
Donator të huaj	3 ☐
Donacione individuale të qytetarëve	4 ☐
Donacione nga biznesi	5 ☐
Kuotizacionet e anëtarëve	6 ☐
Të ardhura nga shërbimet e organizatës	7 ☐
Tjetër _____	8 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

4.4 Sipas mendimit tuaj, sa të rëndësishëm janë faktorët e mëposhtëm në përcaktimin e përparësive të shoqërisë civile në zonat rurale/periferike? (Rendisni sipas rëndësisë nga 1 në 5, ku 1 është më i rëndësishmi.)

Përparësit e identifikuara nga vetë komuniteti i zonës rurale/periferike	1 ☐
Përparësit e përcaktuara nga donator të huaj	2 ☐
Interes/nevojat e grupeve të ndryshme sociale	3 ☐
Interes/nevojat e grupeve të marxhinalizuara	4 ☐
Strategjitë kombëtare/lokale të zhvillimit	5 ☐
Tjetër _____	6 ☐

4.5 A ka organizata plan zhvillimi për 3 apo 5 vjetët e ardhshëm?

Po	1 ☐
Jo	2 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

SEKSIONI V

Bashkëpunimet

5.1 Gjatë vitit të fundit (shtator 2010 – shtator 2011), a keni mbajtur ndonjë mbledhje/takim pune me organizata të tjera që punojnë në zonat rurale?

Po	1 ☐
Jo	2 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

5.2 Gjatë vitit të fundit, a keni shkëmbyer informacion/të dhëna/dokumente me organizata të tjera?

Po	1 ☐
Jo	2 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

5.3 Gjatë vitit të fundit, a keni pasur ndonjë projekt të përbashkët me organizata të tjera të shoqërisë civile?

Po	1 ☐
Jo	2 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

5.4 Gjatë vitit të fundit, a keni pasur ndonjë bashkëpunim me institucione të pushtetit vendor?

Po	1 ☐
Jo	2 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

5.5 Në përvojën tuaj të deritanishme, bashkëpunimet tuaja më të shpeshta kanë qenë me (rendit sipas rëndësisë, ku 1 – më i rëndësishmi):

Organizata të tjera që punojnë në zonën ku punon edhe organizata juaj	1 ☐
Organizata të nivelit kombëtar	2 ☐
Organizata ndërkombëtare apo/dhe donatorë	3 ☐
Institucione të pushtetit vendor	4 ☐
Institucione të pushtetit qendror	5 ☐

Komunitetin lokal	6 ☐
Median	7 ☐
Tjetër _____	8 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

5.6 A është organizata juaj anëtare formale e ndonjë grupi, rrjeti (network-u), organizate ombrellë etj?

Po	1 ☐
Jo	2 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

5.7 Sa shpesh i informoni qytetarët për shërbimet/veprimtaritë e organizatës tuaj?

Një herë në muaj	1 ☐
4 herë në vit	2 ☐
2 herë në vit	3 ☐
1 herë në vit	4 ☐
1 herë në disa vite	5 ☐
Kurrë	6 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

5.8 Cilat janë mjetet kryesore që përdorni për informim?

Publikime (fletëpalosje, broshura, buletine etj)	1 ☐
Raport vjetor	2 ☐
Takime me komunitetin	3 ☐
Media (gazeta, radio, TV) lokale	4 ☐
Trajnime/seminare	5 ☐
Të tjera (specifiko) _____	6 ☐

5.9 A jeni të informuar rreth planeve të punës të bashkisë/komunës për zhvillimin e zonës ku punoni?

Plotësisht i/e informuar	1 ☐
I/e informuar pjesërisht	2 ☐
I/e pa-informuar krejtësisht	3 ☐
Nuk di / Refuzim	99 ☐

5.10 Bazuar në përvojat tuaja, bashkëpunimet më të frytshme kanë qenë me:

OJF të tjera lokale	1 ☐
OJF të mëdha në nivel kombëtar	2 ☐
OJF të huaja	3 ☐
Organizata biznesi	4 ☐
Pushtetin vendor	5 ☐
Zyrat rajonale të donatorëve	6 ☐
Tjetër _____	7 ☐
Nuk e di / Refuzim	99 ☐

Ju faleminderit.

10.3. Intervista e fokusuar në grup

Çështjet për t'u diskutuar:

1. Vështirësi dhe problematika specifike vetëm për zonat rurale.
2. Marrëdhënia shoqëri civile – komunitet: Përse ka një lloj marrëdhënie mosbesimi (siç sugjeron edhe analiza e të dhënave sasiore)
3. Marrëdhënia shoqëri civile – pushtet vendor: Përse pushteti vendor pretendohet se e sheh shoqërinë civile si konkurrente?
4. Marrëdhënia me komunitetin e biznesit rezulton shumë e vakët. Cila është e ardhmja që shihet në këtë drejtim?
5. Stafet e organizatave të shoqërisë civile në zonat rurale rezultojnë të kenë qene pak të trajnuara, ndërkohë që kur pyeten nëse mund të japin ato trajnime shprehen në shumicë të gatshme. Cila është e mesmja në këtë drejtim? Sa nevojë ka për ngritje kapacitetesh? Çfarë mund të mbulohet nga aktorët lokalë dhe cilat janë fushat me imediate?
6. Pretendohet se marrëdhënia me komunitetin, përfituesit mbahet kryesisht përmes takimeve në komunitet. Po kështu thuhet se përparësit e komunitetit kthehen shpesh edhe në përparësi të axhendës së shoqërisë civile. Si qëndron realiteti në këtë drejtim? Si funksionojnë këto takime dhe identifikimi i përparësive?
7. Një vëzhgim i përgjithshëm është se aktorët e shoqërisë civile e kanë të vështirë të gjejnë të meta apo kufizime të tjera dhe fokusohen kryesisht tek vështirësitë financiare.

- a. A mundet që të identifikohen disa pika të dobëta?
 - b. Si e mendojnë çështjen e qëndrueshmërisë, vazhdueshmërisë dhe mbështetjes financiare? Çfarë shpresojnë dhe çfarë planifikojnë?
8. Cili është imazhi i shoqërisë civile në këto zona që kanë ata për të ardhmen? Për të arritur aty, cilët janë aktorët që identifikojnë dhe përgjegjësitë konkrete?